



USHTRIA



Viti i 70-të i botimit Nr. 46 (82691)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 4 nëntor 2016

LU: FA - NJË NGA TRE OBJEKTIVAT E SHBA-VE NË SHQIPËRI



Ditën e mërkurë, Ambasadori i SHBA-ve në Tiranë, Donald Lu nëpërmjet Facebook në një komunikim on-line u është përgjigjur pyetjeve të shumta të qytetarëve lidhur me situatën në vend, reformën në drejtësi, marrëdhëniet me SHBA-në, etj. Pyetjes për ushtrinë shqiptare, se a kanë SHBA-të ndonjë plan për të forcuar dhe modernizuar Forcat e Armatosura shqiptare, am-

basadori Lu ju pergjigj: Ambasadori Lu: "Është një nga tre objektivat e qeverisë së SHBA në Shqipëri: ta ndihmojmë Shqipërinë të jetë një aleate më e fortë e NATO-s. Jemi duke bërë një numër gjërash për të ndihmuar forcat ushtarake. Së pari, i kemi dhënë Shqipërisë mundësinë të shkollojë oficerë dhe ushtarë shqiptarë në Shtetet e Bashkuara. Së dyti, kemi sjellë trajnime këtu në Shqipëri, trajnime

» faqe 2

GJERGJ BASTA
(1550-1607) strateg dhe teoricien i shquar ushtarak



» faqe 8

Rezoluta 1325 e OKB Gratë në uniformë 14% e efektivit të FA

Ministrja Kodheli: "Kam propozuar për gradim të parën grua gjenerale të Forcave të Armatosura"

» faqe 3

Stërvitja "JCET-16"

Forcat speciale dhe amerikanët "shpëtojnë" pengjet

Forcat speciale të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, bashkë me forcat speciale të komisaritit special "RENEA" dhe efektivë nga Grupi i 19 i Forcave Speciale amerikane, morën pjesë në stërvitjen Joint Combined Exchange Training, JCET, e cila u zhvillua në vendin tonë në periudhën 1-31 tetor

» faqe 5



KDS

Promovohet libri "Vrasja Tellini" i Andrea Giannasit

Në ambjentet e Auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes, nën kujdesin e veçantë të Komandantit të KDS-së Gjeneral Brigade Dedë Prenga dhe në bashkëpunim me Dhomën e Impreditorëve Italianë u bë promovimi i librit "Vrasja Tellini" i Andrea

» faqe 8



"REZOLUTA 1325: TË DREJTAT E GRAVE – NGA KONCEPTI NË REALITETIN SHQIPTAR",

31 TETOR 2016

16 - Vjetori i Miratimit të Rezolutës 1325 nga Këshilli i Sigurisë i Kombeve të Bashkuara

WUN FUND FOR GENDER EQUALITY



AKTIVITETI
Përfaqësues të OSBE vizitojnë Bazën Ajrore Farkë

» faqe 11

SENSIBILIZIMI

Mamografi falas për gratë ushtarë e civile të FA

faqe 3

BASHKËPUNIMI

Orkestra Frymore e FA jep koncertin "Këndo shqip"

faqe 4

Lu: FA - një nga tre objektivat e SHBA-ve në Shqipëri

Ditën e mërkurë, Ambasadori i SHBA-ve në Tiranë, Donald Lu nëpërmjet Facebook në një komunikim on-line u është përgjigjur pyetjeve të shumta të qytetarëve lidhur me situatën në vend, reformën në drejtësi, marrëdhëniet me SHBA-në, etj. Pyetjes për ushtrinë shqiptare, se a kanë SHBA-të ndonjë plan për të forcuar dhe modernizuar Forcat e Armatosura shqiptare, ambasadori Lu ju përgjigj:

Ambasadori Lu: “Është një nga tre objektivat e qeverisë së SHBA në Shqipëri: ta ndihmojmë Shqipërinë të jetë një aleatë më e fortë e NATO-s. Jemi duke bërë një numër gjërash për të ndihmuar forcat ushtarake. Së pari, i kemi dhënë Shqipërisë mundësinë të shkollojë oficerë dhe ushtarë shqiptarë në Shtetet e Bashkuara. Së dyti, kemi

sjellë trajnime këtu në Shqipëri, trajnime intensive për forcat tuaja speciale. Së treti, kemi krijuar kapacitetet brenda forcave të armatosura shqiptare për një përgjigje të nivelit të klasit botëror për identifikimin dhe çarmatimin e eksplozivëve. Gjithashtu, po mbështesim me para, teknologji dhe pajisje për modernizimin e forcave ushtarake dhe po i ndihmojmë ato të jenë në përputhje me standardet e NATO-s. E fundit, por do të thoja dhe më e rëndësishmja, ne punojmë me Ministrën e Mbrojtjes dhe Forcat e saj të Armatosura për t'u siguruar që të flitet për të drejtat e njeriut në forcat ushtarake, dhe për korrupsionin, sepse ne besojmë që në fund të fundit NATO nuk është vetëm një forcë ushtarake, por edhe një aleancë vlerash”.



INTERVISTA

FA garante për siguri dhe integritet territorial

Ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli sapo është kthyer nga ministeriali i mbrojtjes që u mbajt pak ditë më parë në Bruksel. Ajo shpjegon, në këtë intervistë, se “vendi ynë ka tashmë një strategji afatgjatë të sigurisë dhe mbrojtjes, të parë nga këndvështrimi i një vendi anëtar i Aleancës, miratuar në parlament më shumë se një vit më parë”. “Ndaj ministerialet NATO janë një konfirmim i angazhimeve të përbashkëta, për pasojë dhe i angazhimeve tona, si vend anëtar, angazhime këto që prodhojnë siguri. Por, kjo nuk do të thotë që Shqipëria është immune ndaj rrezikut, asnjëherë nuk do të thotë që Shqipëria nuk rri në një rajon me problematika apo në një botë që ka problematika e saj të sigurisë i ka për kryefjalë, por nga ana tjetër do të thotë më shumë qetësi dhe siguri brenda kufijve tanë”, u shpreh Kodheli. E pyetur në lidhje me propozimin e bërë pak ditë më parë, nga ministri i Drejtësisë për ndërhyrjen e ushtrisë në luftën ndaj kanabisit në vend, ministrja Kodheli u shpreh: “Forcat e Armatosura kanë detyrë të mirë përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligjet që rrjedhin prej këtij detyrimi. Forcat e Armatosura janë të gatshme t'i përgjigjen pozitivisht të gjithë situatave të emergjencave që konsiderohen të tilla me një vendimarrje të qeverisë”. “Sigurisht që, nëse propozimet vijnë nga drejtues të ndryshëm institucionesh ose pse jo nga anëtarë të qeverisë për të trajtuar një temë të caktuar, ka një vendimarrje të Këshillit të Ministrave”, tha Kodheli.

Zonja Kodheli, ju morët pjesë në takimin e ministrave të Mbrojtjes së NATO-s në Bruksel për përfundimin e mbrojtjes kolektive të NATO-s. Çfarë do të thotë kjo për Shqipërinë?

Atëherë, me shpresën se nuk bie në përsëritje ju them se që nga momenti që Shqipëria është futur në NATO, si anëtare me të drejta të plota, ka ndryshuar koncepti, ka ndryshuar mënyra, sistemi i mbrojtjes se kufijve shqiptarë, i ruajtjes së integritetit të vendit dhe përfaqja ndaj sigurisë së qytetarëve. Mbrojtja kolektive presupozon një mbrojtje të përbashkët të të gjithë vendeve anëtare të NATO-s, bazuar në lajtmotivin: “Të gjithë për një dhe një për të gjithë”. Kjo do të thotë ndryshim në koncept të mbrojtjes nga ajo individuale, në mbrojtje kolektive. Ka dy shtylla kryesore të veprimtarisë se FARSH: Njëra është respektimi i detyrimeve kushtetuese dhe zbatimi i të gjitha ligjeve që rregullojnë këtë detyrim kushtetues dhe tjetra është plotësimi një për një i angazhimeve tona në NATO, pikërisht për shkak të këtij koncepti. Kjo e bën Shqipërinë pa dyshim, më të sigurtë, por edhe me një prestigj më të madh ndërkombëtar. Vendi ynë ka tashmë një strategji afatgjatë të sigurisë dhe mbrojtjes, të parë nga këndvështrimi i



një vendi anëtar i Aleancës, miratuar në parlament më shumë se një vit më parë. Kjo strategji mbart në vetvete edhe angazhime ndërkombëtare, përveç atyre kombëtare. Ndaj ministerialet NATO janë një konfirmim i angazhimeve të përbashkëta, për pasojë dhe i angazhimeve tona, si vend anëtar, angazhime këto që prodhojnë siguri. Por, kjo nuk do të thotë që Shqipëria është immune ndaj rrezikut, asnjëherë nuk do të thotë që Shqipëria nuk rri në një rajon me problematika apo në një botë që ka problematika e saj të sigurisë i ka për kryefjalë, por nga ana tjetër do të thotë më shumë qetësi dhe siguri brenda kufijve tanë.

A do të marrë pjesë Shqipëria në një mision ushtarak në Siri nëse do t'i kërkohej?

Çdo vendimarrje dhe aq më shumë prezencë e NATO-s me misionë është një vendimarrje kolektive. Nuk mund të merret asnjë vendim që nuk është kolegjal. Qoftë edhe sikur një

anëtar të abstenojë ose të ketë kundërshti, misioni nuk kryhet dhe për pasojë nuk ka trupa të NATO-s në atë territor apo në atë mision. Bazuar në vendimarrjen që NATO merr, Shqipëria merr vendimet e saj nëse do t'i bashkohet një misioni apo jo.

A do të ketë rritje të efektivit ushtarak pasi aktualisht janë rreth 8500 veta?

Nuk ka pse të ketë. Shifra 8500 veta forcë aktive ushtarake ka ardhur si rrjedhojë e një studimi të kahershëm, studim të bërë nga Ministria e Mbrojtjes dhe SHPPA, me mbështetjen e partnerit tonë strategjik SHBA, dokument ky i përfunduar si i tillë, nëse nuk gaboj, në prill të vitit 2013, mbi bazën e të cilit janë miratuar edhe limitet e numrit të FARSH. 8500 veta janë më shumë se sa të mjaftueshëm për të zbatuar kushtetutshmërinë dhe për t'i garantuar vendit siguri dhe territorit shqiptar integritet.

Të gjitha raportet flasin për një rritje të toneve nacionaliste në Ball-

kan. Pamë kërcënimin e Kotzias, nga ana tjetër Maqedonia, Serbia, e cila ka rritur shpenzimet për mbrojtjen për sa i përket armatimit. Po Shqipëria çfarë qëndrimi do të mbajë në këtë situatë, ndërkohë që është i vetmi vend në Ballkan që nuk ka tanke apo që hapësirën ajrore ja ka besuar fqinjëve të tij?

Ju korrigjoj, Shqipëria nuk është i vetmi vend i NATO-s që hapësirën ajrore ia ka besuar fqinjëve të saj. Janë disa vende, anëtare të NATO-s, hapësirën ajrore të të cilave e ruajnë aleatët. Kjo është ekzaktesisht pjesë e asaj për çka ne folëm më sipër, pra e mbrojtjes kolektive. Pra, Shqipëria çon forca të armatosura, diku në kufijtë e largët lindorë NATO, por nga ana tjetër mbrohet nga aleatët kur bëhet fjalë për hapësirën ajrore. Vendi ynë nuk ka asnjë problem me vendet fqinje aq më pak me vende fqinje anëtare të Aleancës. Rasti i Serbisë që ka rritur shpenzimet e mbrojtjes, është një problem i brendshëm i Serbisë. Ne, gjithashtu, na kërkohet që të rrisim shpenzimet për mbrojtjen dhe e kemi bërë. Kjo sigurisht, sepse mjedisi i sigurisë sot është një mjedis që e kërkon këtë gjë dhe, në vlerësimet që vijnë nga NATO, rezultoni që ka nevojë për të rritur investimet, trajnimet, mirë armatimin e forcave të Armatosura. Kjo thjesht dhe vetëm e bën rajonin më të sigurtë. Besoj që ne do të vazhdojmë të ecim me këtë hap dhe me këtë ritëm, duke rritur buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, por nga ana tjetër duke i harxhuar paratë e taksapagueseve në mënyrë racionale me qëllim rritjen e gatishmërisë dhe përgatitjes ushtarake.

Keni shprehur një qëndrim pak ditë më parë në lidhje me luftën kundër kanabisit. Pati një propozim nga Ministri i drejtësisë, Ylli Manjani për përfshirjen e ushtrisë në këtë aksion. Përshtypja e përgjithshme është që kemi të bëjmë me një situatë të rëndë të përhapjes së Kanabisit. A mund të ketë vend në këtë luftë edhe për ushtrinë?

Qëndrimi im, ka qenë qëndrim i ministrit të Mbrojtjes së një vendi sa anëtar të NATO-s, aq edhe të një vendi demokratik. Forcat e Armatosura kanë detyrë të mirë përcaktuara

në Kushtetutë dhe në ligjet që rrjedhin prej këtij detyrimi. Forcat e Armatosura janë të gatshme t'i përgjigjen pozitivisht të gjithë situatave të emergjencave që konsiderohen të tilla me një vendimarrje të qeverisë. Sigurisht që, nëse propozimet vijnë nga drejtues të ndryshëm institucionesh ose pse jo nga anëtarë të qeverisë për të trajtuar një temë të caktuar, ka një vendimarrje të Këshillit të Ministrave. Bazuar në këtë vendimarrje dhe në zbatueshmëri të ligjeve shqiptare, që kanë të përcaktuara qartë fushat e veprimtarisë së çdo institucioni, merren masa për t'ju përgjigjur kësaj vendimarrjeje.

Jeni në fund të mandatit të parë, a do të dëshironit një dikaster tjetër në rast të fitores së rishmë të zgjedhjeve nga e majta?

E rëndësishme është që ne, në fund të katërvjeçarit, të dalim me rezultate pozitive nga qeverisja e katër viteve të para, të kemi përmbushur, jo vetëm pritshmëritë e mëdha të njerëzve, por njëkohësisht edhe ato çka kemi premtuar. Kjo nuk është e mjaftueshme, gjithsesi unë e besoj që ky mandat kishte kostot e veta, për shkak të reformave të thella që ne ndërmorëm që në fillim të qeverisjes sonë, ndërkohë, që mandati tjetër do të na duhet për të vënë në zbatim në mënyrë të gjerë reformat që nisëm mandatin e parë. Ndaj gjëja më e rëndësishme është, prosperimi i Shqipërisë dhe nuk është asfare e rëndësishme, nëse unë do të jem pjesë e qeverisë së ardhshme.

Pas rënies së helikopterit ushtarak në liqenin e Shkodrës kjo çështje u harrua. A nxori ekspertiza se cili e kishte përgjegjës?

Unë besoj se kjo është një pyetje që i takon prokurorisë dhe strukturave përkatëse që merren me këtë çështje. Çështja e liqenit të Shkodrës dhe e aksidentit të helikopterit ushtarak, për FA dhe Ministrinë e Mbrojtjes është një çështje që nuk do të harrohet, sepse nuk do të harrohen dy “Dëshmorët e Atdheut”, heronj të nderuar dhe të respektuar të FA, të cilët do të mbeten përgjithmonë në zemrat e gjithëkujt që i ka njohur dhe në zemrën time po aq.

Intervistoi:
Darina Tanushi/
“Gazeta Shqiptare”/

REZOLUTA 1325 E OKB

Gratë në uniformë 14% e efektivitetit të FA

Ministrja Kodheli: "Kam propozuar për gradim të parën grua gjenerale të Forcave të Armatosura"

Ministrja e Mbrojtjes znj. Mimi Kodheli ishte ditën e henë, më 31 tetor, në tryezën: "Rezoluta 1325: të drejtat e grave, nga koncepti në realitetin shqiptar" i Shoqatës së Grave me Probleme Sociale (SHGPS) në bashkëpunim me organizatën suedeze "Operation 1325" dhe me mbështetjen e Ambasada-së së Mbretërisë së Vendeve të Ulta në Shqipëri. Ministrja e Mbrojtjes falënderoi të gjitha zonjat që organizuan këtë tryezë të rrumbullakët për të drejtat e grave në Shqipëri, e parë nga këndvështrimi i Rezolutës 1325 të Kombeve të Bashkuara. "Aktivitete të tilla na angazhojnë më së pari ne, anëtarëve të qeverisë, por edhe atyre të parlamentit, së bashku me aktorë dhe faktorë të shoqërisë civile, për të mundësuar sigurimin e të drejtave të grave në fushën e paqes dhe sigurisë", u shpreh ajo.

"Ky diskutim bëhet akoma më i rëndësishëm nga fakti që, po flasim sot për rolin e grave në vendim-marrje në fushën e paqes dhe të sigurisë. Nisma e Organizatës së Kombeve të Bashkuara pikërisht 16 vjet më parë, për të miratuar një rezolutë për pjesëmarrje të plotë e të barabartë të grave ka gjetur mbështetje të madhe në të gjitha vendet anëtare. Qeveria shqiptare është një shembull i mirë sesi një e treta e kabinetit përbëhet nga gra profesioniste që mbajnë portofol nga më të rëndësishmet në qeverisje", vijoi më tej ministrja Kodheli.

Znj. Kodheli më tej tha se në punën e saj si ministre e Mbrojtjes, pas mbrojtjes së atdheut, kryesore janë pikërisht sfidat e sigurisë që



vijnë nga rajonet e destabilizuara të botës, aty ku ushtarakët shqiptarë angazhohen çdo ditë për vendosjen e paqes dhe ngritjen e strukturave të sigurisë të vendeve në nevojë. Ajo theksoi se sot një femër ushtarake shqiptare punon si këshilltare për Forcat Speciale në Ministrinë e Mbrojtjes së

Afganistanit. "Nga hera e fundit që jemi takuar së bashku, gratë që na përfaqësojnë në shtabe dhe struktura ushtarake ndërkombëtare janë trefishuar vetëm për 6 muaj, ndërsa punojnë si drejtore në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm gati dy herë më shumë se sa gjashtë muaj më

parë, falë një sistemi të kujdesshëm promovimi dhe përparimi në karrierë", u shpreh Kodheli.

Më tej ministrja e Mbrojtjes e vuri theksin tek gratë në uniformë, të cilat përbëjnë 14% të gjithë efektivitetit ushtarak, duke pësuar një rritje të qenësishme gjatë tre viteve të fundit të

mandatit të qeverisjes. Por nuk është vetëm rritja sasimore ajo që vlen për t'u përmendur, por dhe shtimi i numrit të grave në pozicione të larta drejtuese. Gjatë gradimit të fundit në Forcat e Armatosura, zhvilluar një muaj më parë, 30% e të graduarve kolonel janë gra. "Dhe sot, pak përpara se të vijë këtu, kam propozuar për gradim të parën grua gjenerale të Forcave të Armatosura. Në mënyrë që propozimi i kësaj zonje, të mbajë këtë datë të veçantë të 31 tetorit, ditës kur Kombet e Bashkuara miratuan pikërisht Rezolutën 1325", - vijoi më tej Kodheli.

Ministrja Kodheli e mbylli fjalën e saj duke ritheksuar se gjithmonë do të na duhet më shumë angazhim i grave për një botë më të paqte dhe të sigurt. Dhe jemi ne vetë që duhet ta bëjmë ndryshimin. "Bashkë mund t'ia mbërrijmë, bashkë jemi më shumë dhe më të fortë", - përfundoi ajo. Tryeza për të drejtat e grave, është një nismë e OKB, e iniciuar 16 vjet më parë pikërisht me datën 31 tetor.

Mamografi falas për gratë ushtarake e civile të FA

Në kuadër të muajit të sensibilizimit kundër kancerit të gjirit, nën kujdesin e veçantë të ministres së Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes për një javë të plotë është në dispozicion të grave ushtarake dhe civile një makinë lëvizëse për kryerjen e mamografisë falas.

Ditën e martë, në ditën e dytë të vizitave mori pjesë edhe ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, e cila bashkëbisedoi me gratë që ishin të pranishme për kryerjen e ekzaminimeve. Një bisedë të ngrohtë ajo zhvilloi edhe me znj. Silvana Markgjoni, e cila ka luftuar për 21 vite me radhë me këtë sëmundje, duke e fituar këtë betejë jetësore vetëm falë vendosmërisë së saj. Në fjalën e saj drejtuar grave të pranishme, znj. Silvana Markgjoni u bëri thirrje që të mos kenë frikë nga kontrolli. "Shoh shumë shpesh gra të trembura për të bërë mamografinë, tremben nga kontrolli, tremben nga e vërteta dhe ky është gabimi më i madh që ato mund të bëjnë" - tha znj. Markgjoni. Më tej, ajo u shpreh se të gjitha gratë duhet të mendojnë që vetëm një mamografi e thjeshtë që bëjnë, ju fal



SENSIBILIZIMI

Ministra e Mbrojtjes në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë për të tretin vit radhazi kanë zhvilluar konsulta dhe mamografi falas nga mjekë specialistë në fushën e onkologjisë të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza".

jetën për të afërmit, për fëmijët, për veten e tyre. Ju fal këtë jetë që është kaq e bukur.

Në fjalën e saj ministrja Kodheli

vlerësoi guximin, trimërinë dhe vendosmërinë e znj. Silvana Markgjoni, për t'i demonstruar vetes dhe të tjerëve që ne mund t'ia dalim vetëm



duke bërë mamografinë. "Unë jam një tjetër dëshmi e një personi që bëj rregullisht mamografinë, pavarësisht se çfarë kam bërë në jetë, pavarësisht se sa mundësi kam pasur, pavarësisht në çfarë moshe kam qenë; mbi të 40 e kam bërë mamografinë çdo vit".

Ministrja Kodheli nënvizoi se "Jo vetëm zonjat që janë nën uniformë, që kanë një tjetër qasje ndaj disiplinës edhe detyrimeve që kanë për veten e tyre dhe të tjerët, për përgjegjësitë që mbajnë, por edhe zonjat civile që punojnë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe të gjithë zonjave që punojnë në FA dhe të gjitha zonjat që na dëgjojnë sot, duhet thjeshtë dhe vetëm të gjejnë kohën për t'u diagnostikuar, është shumë e rëndësishme". Në fund të fjalës së saj znj. Kodheli theksoi se kjo është sëmundja e shekullit dhe që po përparon.

"Shpeshherë i dëgjoj njerëzit të thonë që është bërë tumori sikur të jetë një grip dhe, është e vërtetë, ndaj vetëm parandalimi, siç është në rastin e mamografisë, është, le të themi, shpëtimi i vetëm. E kapur në kohë pothuajse në të gjitha rastet është 100% e shërueshme" - tha ministrja e Mbrojtjes.

Ministra e Mbrojtjes në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë për të tretin vit radhazi kanë zhvilluar konsulta dhe mamografi falas nga mjekë specialistë në fushën e onkologjisë të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza". Pas ekzaminimeve që do të kryhen për një javë në ambientet e ministrisë makina lëvizëse e mamografisë do të jetë në dispozicion edhe të punonjëseve ushtarake dhe civile në të gjitha komandat dhe njësitë ushtarake të FA.

Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes

Gjeneral Brigade Cikaqi leksion me studentët e Sigurisë

Më datën 26.10.2016, Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe të Stërviçjes së Forcës së Sigurisë së Kosovës zhvilloi leksion me studentët e Kursit të 8 të Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Gjeneral Brigade Enver Cikaqi, shoqërohej nga atasheu ushtarak i Forcës së Sigurisë së Kosovës N/ kolonel Enver Dugolli.

Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM) është kursi më i lartë në piramidën e arsimit ushtarak në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH). Kursi zhvillohet në gjuhën angleze me pjesëmarrjen e ushtarakëve të gradës kolonel nga FA, vendet e rajonit dhe më gjerë. Pjesëmarrës të këtij kursi ishin përfaqësues nga institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë, ushtarakë të lartë nga Forcat e Armatosura të Italisë, Rumanisë, Greqisë, Gjeorgjisë, Maqedonisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës etj.

Gjeneral brigade Cikaqi në ligjëratën e tij theksoi se bashkëpunimi në fushën e sigurisë është shumë i rëndësishëm për Republikën e Kosovës. Shteti ynë në "Strategjinë Kombëtare të Sigurisë" ka theksuar qartë rëndësinë e bashkëpunimit në lëmin e sigurisë me partnerët strategjikë, regjionalë dhe lokalë. Gjithashtu Gjeneral Cikaqi theksoi se Forca e Sigurisë së Kosovës është duke punuar vazhdimisht në thellimin e këtyre marrëdhënieve me partnerët dhe organizatat ndërkombëtare, duke i përmendur disa nga objektivat e FSK-së në raport me



institucionalizimin e bashkëpunimit në siguri.

Rritja e bashkëpunimit dypalësh me shtetet regjionale, NATO-n dhe shtetet e Bashkimit Evropian. Pjesëmarrja aktive e FSK-së në ushtrimet,

organizimet dhe iniciativat regjionale si dhe në ndërtimin e stabilitetit dhe bashkëpunimit regjional, Rritja e marrëveshjeve dypalëshe etj.

Pas ligjëratës, u zhvillua një debat i mirëfilltë në mes gjeneral

Cikaqit dhe pjesëmarrësve, ku në veçanti u debatua rreth rolit të FSK-së në rritjen e bashkëpunimit në siguri dhe bashkëpunimit ndër-shtetëror me shtetet e Ballkanit në të ardhmen. Gjeneral Cikaqi,

gjatë diskutimit të tij theksoi qartë nevojën e bashkëpunimit të shteteve të regjionit në institucionalizimin e bashkëpunimit në siguri, duke nënvizuar edhe kontributin e çmueshëm të FSK-së në këtë drejtim.

Studenti KLSM-2016 Kolonel Arben Kingji i dha Gjeneral Brigade Enver Cikaqi "Certifikatën e Nderit për pjesëmarrje në lektime në KLSM-2016".

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA Gjeneralmajor Jeronim Bazo priti në takim pune Komandantin e Komandës së Doktrinës dhe të Stërviçjes së Forcës së Sigurisë së Kosovës Gjeneral Brigade Enver Cikaqi, i cili shoqërohej nga Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe të Stërviçjes Gjeneral Brigade Dedë Prenga dhe Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura Kolonel Ruzhdi Kuçi. Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe të Stërviçjes së Forcës së Sigurisë së Kosovës, Gjeneral Brigade Enver Cikaqi zhvilloi një takim pune me Komandantin e Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes Gjeneral Brigade Dedë Prenga dhe Komandantin e Akademisë së Forcave të Armatosura Kolonel Ruzhdi Kuçi.

Orkestra Frymore e FA jep koncertin "Këndo shqip"

Në bashkëpunim me QK-MBMMShP dhe nën kujdesin e veçantë të ministres së Mbrojtjes, znj. Mimi Kodhelit, trupa muzikore e Orkestrës Frymore të FA (OFFA) zhvilloi ditën e diele koncertin muzikor "Këndo shqip". Ky koncert u realizua tek Salla e Universitetit të Arteve me fëmijët e ushtarakëve dhe shoqërisë civile. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe stërviçjes gjeneral brigade Dedë Prenga, drejtorë dhe ushtarakë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm etj. Zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi në fjalën e tij përshëndetëse u shpreh: "E para, ky koncert këndon shqip. Këto talente, ky pasion është një thirrje për ne të rriturit, të bëjmë gjithçka, deri të pamundurën që t'ua bëjmë të lumtur jetën këtyre fëmijëve që ku ata të bëhen sa ne nesër, kur t'ju rikthehen ditëve të tyre të fëmijërisë, t'ju japi fuqi dhe energji për të ardhmen. E dyta, le ta mbrojmë muzikën si një zgjedhje të shëndetëshme, ushqim shpirtëror dhe pse jo si një zgjedhje profesionale shumë të mirë. Dhe e treta, përsa i përket dashurisë për atdheun, atë që bën fuqia e një



ZV. MINISTRU I MBROJTJES, Z. PETRO KOÇI

Le ta mbrojmë muzikën si një zgjedhje të shëndetëshme, ushqim shpirtëror dhe pse jo si një zgjedhje profesionale shumë të mirë. politikanëve"

vargu, atë që bën muzika që të mbush shpirtin nuk e bëjnë dot fjalimet e dhjetra politikanëve". Gjatë aktivitetit u interpretuan këngë dhe valle të ndryshme nga fëmijët, të shoqëruar

edhe nga trupa muzikore e Orkestrës Frymore të FA. Qëllimi i këtij aktiviteti është rikthimi i traditës së interpretimit të këngës për fëmijë me tinguj të vërtetë të botës feminare.



Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes vizitë në Forcën Tokësore

Në kuadër të programit të tij akademik, Kursi i Lartë i Sigurisë dhe Mbrojtjes (KLSM), zhvilloi ditën e mërkurë datë 2 nëntor, një vizitë në Komandën e Forcës Tokësore (FT). Kursantët u pritën fillimisht nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani, i cili shprehu kënaqësinë e tij të veçantë për vizitën e këtij grupi special ushtarakësh në ambientet e FT.

Vizita vazhdoi me një prezantim të mbajtur nga shefi i G-5 në Shtabin e FT, kolonel Sami Neziri. Nëpërmjet këtij prezantimi, të pranishmit patën mundësinë të njihen me historikun, misionin, si dhe disa nga detyrat kryesore të FT.

Më pas, takimi vazhdoi në formën e një bisede dhe diskutimi të hapur, në lidhje me përmbajtjen e prezantimit, ku nga ana e kursantëve (veçanërisht atyre të huaj) u tregua interes i veçantë në lidhje me pjesëmarrjen e efektivave të FT në misionet në kuadër të NATO dhe BE.

Grupi i ushtarakëve të KLSM, u drejtua më pas drejt vendndislokimit të batalionit të Forcave Speciale (bFS) të Forcës Tokësore, ku u njohën konkretisht me armatimin dhe teknikën në përdorim nga këto forca elitë.

Për ndër të vizitorëve nga KLSM, efektivat e bFS, kryen një demonstrim stërviçor, me tema nga ushtrimet trajnuese që ata kryejnë çdo ditë.

STËRVITJA "JCET-16"

Forcat speciale
dhe amerikanët
"shpëtojnë" pengjet

Forcat speciale të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, bashkë me forcat speciale të komisariatit special "RENEA" dhe efektive nga Grupi i 19 i Forcave Speciale amerikane, morën pjesë në stërvitjen Joint Combined Exchange Training, JCET, e cila u zhvillua në vendin tonë në periudhën 1-31 tetor 2016. Stërvitja JCET u zhvillua kryesisht në mjediset stërvitore të batalionit të Forcave Speciale në Garnizonin Zall-Herr, por ajo është shtrirë edhe në disa pjesë të caktuara të qytetit të Tiranës.

Të entjën e javës që kaloi, më 27 tetor, "teatër" i stërvitjes ka qenë Universiteti i Arteve i cili shërbeu si objekt për skenarin e këtij demonstrimi, ku trupat pjesëmarrëse kanë demonstruar disa nga veprimet për të cilat janë stërvitur këto ditë. Skenari synonte t'i afrohej sa më tepër realitetit dhe njëkohësisht të demonstronte kapacitetet dhe aftësitë operacionale, në një operacion të përbashkët të trupave speciale ushtarake dhe atyre policore të përfaqësuar nga komisariati "RENEA".

Skenari: "Ky demonstrim u bazua në një skenar real, ku një grup kriminal merr peng personelin që ndodhen në Universitetin e Arteve të Bukura. Pas dështimit të negociatave të bëra me kriminelët, për shkak se kërkesat e tyre ishin të pabarazueshme dhe përbënin kërcënim për rendin kushtetues, Task-Forca e Operacioneve Speciale, merr urdhërin e ndërhyrjes për të çliruar pengjet. Pas marrjes së sinjalit, Task-Forca koordinon me Drejtorinë e Policisë së Shtetit, bën bllokimin e zonës, vendos pozicionet e snajperave dhe infiltron grupet e depërtimit të cilët infiltrohen nga ajri dhe toka. Pasi dëgjohet zhurma e helikopterit mbi terrace, një kriminel del jashtë derës së objektit, duke mbajtur një peng. Pas identifikimit, snajperi bën eliminimin e pengmarrësit duke i dhënë edhe start lëvizjes për në objektiv të grupeve të ndërhyrjes nga toka. Pas një sinkronizimi perfekt midis grupeve të ndërhyrjes nga ajri dhe grupeve nga toka, realizohet pastrimi i objektit duke çliruar pengjet dhe eliminimin e një pengmarrësi tjetër si dhe neutralizimin/arrestimin e dy pengmarrësve të tjerë".

Ky demonstrim u ndoq nga afër dhe me mjaft interes nga zëvendësministri i Mbrojtjes z. Petro Koçi, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani, atashu ushtarak i SHBA-së në vendin tonë, shefi i zyrës së ODC, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit drejtësi i Parë Haki Çako, drejtori i Forcave Operacionale të Lëvizshme drejtuesi parë Niko Brahimi, komandanti i Komisarariatit "RENEA" drejtues Sokol Poçari, komandanti i batalionit të Forcave Speciale kolonel Eklnd Dauti, drejtorë drejtorish në SHPFA etj.

Në fjalën e tij zëvendësministri i Mbrojtjes z. Ptero Koçi tha se: "Kjo është një stërvitje e përvitëshme dhe më vjen mirë që ne çdo vit e më tepër kualifikohemi më tej për të garantuar sigurinë për të qenë më operabel në veprimtarinë tonë".

Më tej ai i falenderoi për suksesin e kësaj stërvitjeje dhe tha se dhe mirëpresim bashkëpunime të tjera në mënyrë që efikasiteti i këtij bashkëpunimi të jetë maksimal sepse sfidat që kemi përpara janë vërtetë të rëndësishme.

"Ju e dini që terrorizmi është berë



një potencial i rrezikshëm. Natyrisht që nuk ka sinjale që akte të tilla terroriste të ndodhin në vendin tonë por ne duhet të jemi të përgatitur për të përballuar cdo lloj situatë. Situata të cilat mund të ndodhin dhe në vende të tjera ku ne

mund të ndihmojmë me forcat tona të specializuara tashmë për të përballuar rreziqet nga terrorizmi", përfundoi ai.

Infiltrimi nga toka në një godinë të zënë nga elementë keqberës të pidentifikuar, duke mundësuar lir-

imin e pengjeve dhe bonifikimin e objektit, ishte skenari kryesor i këtyre demonstrimeve. Qëllimi i stërvitjes në përgjithësi është rritja e mëtejshme e aftësive operacionale të batalionit të Forcave Speciale si partner i besuar,

i denjë dhe i ndërveprueshëm për kryerjen e misioneve ndërkombëtare, aftësimi si njësi përgjegjëse për të reaguar ndaj organizatave (të mundshme) apo individëve ekstremistë dhe tejet të rrezikshëm, trajnimi i reparteve speciale për të ndërhyrë dhe vepruar në mjedis ndërkombëtar brenda dhe jashtë vendit si dhe rritja e bashkëpunimit me njësitë e tjera ligj-zbatuese, ndërmjet strukturave të Ministrisë së Punëve të Brendshme (RENEA) në kryerjen e detyrave të përbashkëta.

Pas këtij demonstrimi tepër të suksesshëm, çka ishte edhe finalizimi i gjithë këtyre ditëve të stërvitjes, "JCET-16" përfundoi me një ceremoni simbolike, të organizuar në ambientet e vendndislokimit të bFS të Forcës Tokësore në Zall-Herr. Komandanti i bFS kolonel Enklnd Dauti, në fjalimin e tij drejtuar efektiveve pjesëmarrës në "JCET-16" vlerësoi me nota të larta, angazhimin maksimal, seriozitetin dhe aftësitë profesionale të treguara gjatë gjithë periudhës së kësaj stërvitjeje. Ai shprehu besimin se "JCET-16", ka ndikuar ndjeshëm në rritjen e aftësive bashkëpunuese dhe bashkëvepruese midis forcave ushtarake dhe policore, në rastet e operacioneve të përbashkëta në luftën kundër terrorizmit. Një falënderim të veçantë, kolonel Dauti përcolli edhe për efektivat amerikanë të Forcave Speciale, duke i falënderuar për bashkëpunimin dhe për ndarjen e eksperiencës me trupat shqiptare.

Në këtë stërvitje morën pjesë edhe 3 vetë, personel i Forcës Sigurisë Kosovës me statusin "vëzhgues". Stërvitja JCET është stërvitje e cila zhvillohet 2 herë në vit në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me SHBA.

Kapiten Edvin Zguro
Specialist i BCU-s, bFS

BATALIONI I FORCAVE SPECIALE TË FORCËS TOKËSORE


Dinjitoz në CJSE 2016 "Balkan Shield" në Greqi

Në datat 16-23.10.2016 në Bazën ushtarake Liptokarja, Litochoro Greqi, u zhvillua stërvitja B-9 CJSE 2016 "Balkan Shield". Kjo stërvitje, u zhvillua në kuadër të bashkëpunimit të Forcave Speciale Ballkanike, me pjesëmarrës nga 7 vende të Ballkanit si Shqipëria, Greqia (vendi organizator), Rumania, Bullgaria, Serbia, Mali i Zi dhe Bosnje-Herzegovina.

Qëllimi këtij trajnimi konsistonte në rritjen e aftësive ndërvepruese midis njësive të Forcave të Operacioneve Speciale Ballkanike, Standardizimin e Taktikave, Teknikave dhe Procedurave (TTP) me qëllim reagimin e përbashkët në rast krizash rajonale në të ardhmen, në kuadër të bashkëpunimit rajonal në luftën kundër terrorizmit.

Për zhvillimin sa më të mirë të kësaj stërvitjeje në vendin organizator, u zhvilluan 3 konferenca planizuese për këtë qëllim, ku u diskutua mbi: numrin e pjesëmarrësve, paisjet, armatimin dhe municionin, objektivat dhe synimet që duhet të arriheshin, skenarin e detajuar të stërvitjes, si dhe marrëveshjet përkatëse për kalimin ndër-kufitar dhe akomodimin e personelit.

"Balkan Shield" u organizua me SOTU të cilat u formuan me pjesëtar të Forcave Speciale nga të gjitha shteteve pjesëmarrëse, duke u përcaktuar programin e stërvitjes për secilin SOTU dhe detyrën që do të kishte secila SOTU, gjatë zhvillimit të



veprimeve taktike.

Shqipëria, u përfaqësua në këtë aktivitet me 15 efektive (4 oficerë, 11 n/officerë) të batalionit të Forcave Speciale të Forcës Tokësore, të drejtuar nga Komandanti i Kompanisë së Parë të Aksioneve Speciale Direkte, major Bledar Lama.

Efektivët tonë të grupit special, morën pjesë në 6-SOTU me nga 2 efektive SOF për çdo grup. Gjithashtu, u krijua një SOTG që kryente rolin e shtabit epror dhe që planizoi sipas skenarit të përcaktuar (MDMP). Gjatë kësaj stërvitjeje, trupat tona speciale treguan edhe njëherë përgatitje e disiplinë të lartë në realizimin e detyrave të ngarkuara, kjo si rezultat edhe i stërvitjeve apo misioneve të kryera nga Forcat tona Speciale si brenda dhe jashtë vendit.

Temat kryesore që u zhvilluan në këtë stërvitje ishin: "Zbarkim nga helikopteri Tip Chinok-47

me motorra shkretëtire dhe motorra të tjerë duke përdorur municion luftarak", "Rrethim dhe sigurim zone si dhe eliminimin të pikave të forta të kundërshtarit, duke përdorur armët speciale me fishekë luftarak", "Fast rope nga Chinok-47 dhe përdorim e 9 linjave të MEDEVAC " dhe "Përdorimi i snajperit me qitje reale". Kjo qitje u krye nga efektivi snajper i ALB SOF-it.

Në përfundim të kësaj stërvitjeje u zhvillua mësim tregues dhe përmbyllja e stërvitjes sipas një skenari real luftarak, ku mori pjesë dhe Komandanti i Batalionit të Forcave Speciale kolonel Eklnd Dauti, si dhe shumë personalitete të larta të ushtrisë greke, atashu ushtarak të akredituar në Greqi si dhe komandantët e njësive pjesëmarrëse në stërvitjen B-9 CJSE BALKAN SHIELD 2016.

Kapiten Edvin Zguro
Specialist i BCU-së bFS

Flota shqiptare në misionin e NATO-s në Egje

Forcat Detare nëpërmjet një anije, e para në historinë e flotës detare shqiptare, do të marrë pjesë së bashku me ekuipazhin e saj në operacionin e NATO-s në detin Egje, në mesin e muajit nëntor. Monitorimi, njohja e situatës në rajon dhe lufta kundër terrorizmit janë qëllimet e operacionit të NATO-s në Egje. 21 shqiptarët e ekuipazhit të anijes, me në krye kapitenin e rangut të tretë Ilir Çobo, kanë vite që stërviten dhe trajnohen paralelisht me modernizmin e mjeteve dhe pajisjeve për të mbërritur në këtë ditë, për të qenë të barabartë me vendet e NATO-s.

“Nuk ka qenë një detyrë e lehtë. Koha për t’u përgatitur, dokumentacioni përkatës, situatat, njohja e efektivit, përgatitja e tyre morale, sepse kjo ka të bëjë shumë gjatë një stërvitje të tillë. Jemi në fazën kur mund ta shprehim me siguri të plotë se jemi gati për të marrë pjesë si të barabartë në operacion. Ndërkohë është krenari që ne, një ekuipazh shqiptar me një anije shqiptare të përfaqësojnë sa më denjësisht vendin në operacione të tilla, për të kontribuar për sigurinë. Duhet të kemi parasysh se vijmë me historinë e të qenit konsumatorë të sigurisë, ndërsa tani kalojmë në fazën tjetër të të qenit kontribues për sigurinë”, tha kapiteni Ilir Çobo. Me një autonomi prej 6 ditësh lundrimi në det të hapur, anija, përveç monitorimit të hapësirës detare në kuadër të operacionit të NATO-s, është certifikuar edhe për të ndërhyrë në raste emergjencash, kur konstatohen mjete që transportojnë klandestinë.

“Në qoftë se ne rastisim një mjet që nuk ndodhet në emergjencë, pra



nuk rrezikohet jeta e njerëzve, jemi të detyruar të njoftojmë anijen komandë e përmes tyre njoftohet Roja Bregdetare e shteteve përkatëse, të cilat kanë përgjegjësinë territoriale. Më pas vijmë ata për t’i marrë në bordin e tyre. Në rast se kemi persona të cilëve u rrezikohet jeta, jemi të detyruar të japim

ndihmën e parë, ndërkohë që ata i dorëzojmë pranë autoriteteve të vendit që i përkasin ujërat terroitoriale. Kapacitetet janë për mbrojtjen e anijes, jo për sulme ndaj anijëve të tjera. Për këtë janë të montuara dy mitrolozë në bord, përveç armatimit personal të efektivit, i cili kohët e fundit është modernizuar”,

shton më tej kapiteni Çobo. Si çdo herë e parë, ky operacion do të kujtohet gjatë nga ekuipazhi dhe flota detare shqiptare, por njëkohësisht është edhe një provë reale, që tregon se Shqipëria, të paktën në fushën e mbrojtjes, është shumë më pranë standardeve të vendeve të aleancës.

“Jemi në fazën kur mund ta shprehim me siguri të plotë se jemi gati për të marrë pjesë si të barabartë në operacion. Ndërkohë është krenari që ne, një ekuipazh shqiptar me një anije shqiptare të përfaqësojnë sa më denjësisht vendin në operacione të tilla, për të kontribuar për sigurinë. Duhet të kemi parasysh se vijmë me historinë e të qenit konsumatorë të sigurisë, ndërsa tani kalojmë në fazën tjetër të të qenit kontribues për sigurinë”

Akademia e N/oficerëve



Fillon kursi i Kryekapterit, 4 javë për 10 kursantë

Në datën 24.10.2016 në Akademinë e N/oficerëve “Thomson” në mbështetje të Urdhrit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm me Nr 1130 datë 14.10.2016 filloi kursi i Kryekapterit. Kursi i Kryekapterit i cili zgjat 4 javë dhe ka gjithsej 10 kursantë, të cilët vijnë nga reparte të ndryshme të FA-së. Objektivi i kursit është zhvillimi i elementëve themelorë të personalitetit të Kryekapterit si këshilltar i komandantit të njësisë dhe forcës si dhe detyra të njehsuara me të. Programi mësimor është i fokusuar në zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive intelektuale, ai synon formimin e personalitetit të kryekapterit në nivelin e ngarkesave dhe të përgjegjësisve të funksionit organik si dhe ofron standarte për veprimtarinë e tij në strukturat homologe ndërvepruese të vendeve anëtare dhe partnere të NATO-s. Në ditën e parë të kursit Zv/komandanti i ANO-së N/Kolonel Muhamed Guza në takimin e zhvilluar me rastin e fillimit të kursit ju uroj mirëseardhjen në Akademi dhe theksoi se vetëm serioziteti, përkushtimi dhe disiplinën e lartë do të ishin tre shtyllat që e kanë suksesin të garantuar.



Shtabi i KDS-së kampion në Minifutboll

Në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes është zhvilluar kampionati i Minifutbollit midis Institucioneve të KDS-së. Në këtë aktivitet morëm pjesë ekipi i Shtabit të KDS-së, Qendrës së Doktrinës dhe Kërkimit, Qendrës së Simulimit dhe Akademisë së Nënoficerëve “Thompson”. Ekipet luajtën me njëra tjetren me sitemin e grumbullimit të pikëve, ku Shtabi KDS-së arriti të marrë tre fitore dhe u rendit në vend të parë duke ngritur kështu edhe kupën.

Komanda Mbështetese

Qendra Stërvitore- ngarkesë maksimale në trajnime

Në ambientet e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse vijnë katër kurse shumë të rëndësishme për ngritjen profesionale dhe karrierën e oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve në Forcat e Armatosura. Kursi Bazë i Oficerit Specialiteti Furnizim, Kursi Anglisht niveli i I-rë, Kursi EOD niveli i I-rë dhe Kursi për drejtuesit e mjeteve ushtarake që transportojnë mallra të rrezikshme. Krahas ushtarakëve efektiv të kompanisë EOD që po trajnohen në këtë Qendër ka edhe

dy efektivë të MPB (Policisë Shtetit), duke mundësuar që edhe këto struktura sigurie që ndeshen çdo ditë me krimin të trajnohen e çertifikohe nga specialistët e kësaj Qendre. Të gjitha këto kurse janë rruga kryesore e aftësimin profesional për të qenë në nivelin e realizimit me sukses të detyrës në pozicionet që kanë në Forcat e Armatosura, ngjitjes në karrierën ushtarake. Stafii mësimdhënës dhe drejtuesit Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse tashmë kanë përvojën e duhur në të gjitha fushat trajnuese dhe janë të angazhuar maksimalisht në ndihmë të kursanteve me synimin që nga kjo Qendër Stërvitore të dalin ushtarak të trajnuar në nivele të barabartë dhe konkurentë me koleget e tyre në ushtritë e Aleancës Euro Atlantike.



KOMANDA MBËSHETËSE

Kontributi i specialistëve EOD në projektin e TAP

Specialistët e kompanisë EOD të Komandës Mbështetëse vijojnë angazhimin në ndihmë të projektit më të madh energjitik në Rajon TAP (Trans Adriatic Pipeline), përkatsisht në Qarkun Fier dhe Berat. Puna për ndërtimin e çdo segmenti kërkon kushte të rrepta sigurie pasi në vendin tonë ka ndotje nga municionet e ndryshme si pasojë e luftërave në kohë të ndryshme. Kompania EOD si struktura e vetme e certifikuar për misionet të tilla ka kaluar në ndihmë të projektit duke bërë të mundur kontrollin e imtësishëm të gjurmës ku gazsjellsi kalon. Operatorët EOD po kontrollojnë thellësinë deri në 6 m.

Specialistët EOD aktualisht po punojnë në zonën Vajkan Fier me 12 operatore si dhe Otlak Berat me 6 operatore EOD të kompletuar dhe mbështetur nga teknika përkatese. Operatorët janë fokusuar në kontrollin

linear të gjurmës ku do të vëndosen tubacionet e TAP si dhe në kontrollin po me mjetet teknike speciale të rajoneve ku do jenë stacionet e instalimeve të paisjeve të këtij projekti. Sipërfaqja e kontrolluar është mbi dy mijlon m². Specialistëve EOD u është dashur të angazhohen edhe në pastrimin e rajoneve të mësipërme nga bimësia e lartësive të ndryshme për të mundur kontrollin e sigurtë. Gjatë operacionit ka patur raste të gjetjes së mbetjeve të rrezikshme. Kompania EOD e Komandës Mbështetëse ka fituar besueshmërinë edhe para kompanive serioze ndërkombëtare duke u angazhuar në një projekt kaq të rëndësishëm, kjo tregon edhe një herë aftësitë tekniko-profesionale të specialistëve EOD, përkushtimin, seriozitetin dhe disiplinën e lartë formale dhe profesionale.



Ekspertë amerikanë nga USAREUR

Forca Tokësore, seminari "HUMINT Capabilities"

Në kuadër të bashkëpunimit me strukturat e NATO, nga data 26-28 Tetor në mjediset e sallës së konferencave të Forcës Tokësore, u zhvillua seminari "HUMINT Capabilities" (Human Intelligence Capabilities). Ky aktivitet, u zhvillua në bashkëpunim dhe nën drejtimin e ekspertëve amerikanë nga USAREUR dhe kishte për qëllim familjarizimin me termat, konceptet, funksionin, procedurat, etj., në mbështetje të operacioneve HUMINT. Pjesëmarrësit në seminar, vinin nga strukturat e zbulimit të Forcës Tokësore (G2 dhe S2), si dhe nga efektivi i nënrepartit "HUMINT" të kësaj Force. Ndër temat kryesore që u trajtuan ishin: familjarizimi i personelit HUMINT me standardet e NATO HUMINT; njohja me doktrinat kryesore të zbulimit me njerëz; terminologjia që përdoret nga HUMINT; detyrat e personelit HUMINT në përgatitjen me zbulim të fushës së luftimit (IPB); ndikimi i HUMINT në MDMP (Military Decision Making Process) etj.. Zhvillimi i këtij trajnimit dhe informacioni që u përcoll nëpërmjet tij, do t'iu shërbejë të gjithë pjesëmarrësve, për rritjen e aftësive të tyre profesionale, veçanërisht trupave tona që shërbejnë në Afganistan dhe operacione të tjera, pasi informacioni



grumbulluar në terrenin armiqësor, është shumë i rëndësishëm në mbrojtjen e jetës së efektivave tona, si dhe në suksesin e operacionit.

Seminari u mbyll me ndarjen e certifikatave për pjesëmarrësit, nga shefi i Shtabit të FT kolonel Toska dhe shefi i G-2 nënkolonel Kërcajliu.

Emergjencë tek Shtëpia e Pushimit, pastrohet plazhi

Dhjetëra kuadro dhe punonjës civilë të Shtëpisë së Pushimit dhe Batalionit të Mbështetjes së Forcave të Armatosura, në bashkëpunim edhe me Kompaninë Mbështetëse në Komandën e Forcës Detare, zhvilluan një aksion për pastrimin e plazhit. Sipërfaqja para godinave ishte mbuluar nga mbetje e plehra të ndryshme, si rezultatet i kohës së keqe me shi, erës e dallgëve të detit. Shtëpia e Pushimit të Ushtarakëve Durrës, në bashkëpunim me Komandën e Forcës Detare do të organizojë aksione të shpeshta me personelin dhe mjetet në dispozicion, për të mbajtur vazhdimisht pastër jo vetëm zonën e plazhit, por dhe mjediset e territoreve rrotull ambienteve të Shtëpisë së Pushimit të Ushtarakëve dhe Komandës së Forcës Detare Durrës.



Kthimi i pjesës së ndaluar të pensioneve

Procedurat e pagesës për mbi 5.400 ish-ushtarakë

Nëndrejtori i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Ali Emini, shpjegoi vendimin e qeverisë për faljen e detyrimeve të ish ushtarakëve dhe procedurat e pagesës së debisë për mbi 5.400 ish-ushtarakë në pension, të cilëve u është ndaluar në mënyrë të padrejtë një pjesë e pensionit. Këto detyrime shpjegon Emini, lindën si pasojë e llogaritjes së pensioneve bazuar në një ligj të mëparshëm, i ndryshuar më pas me një akt normativ. Meqenëse ligji dhe akti normativ kanë një diferencë në kohë, nga rilogaritja e pensioneve edhe për shkaqe administrative shumë ushtarakë që kishin paga të ulëta ose funksione të ulëta, pjesa më e madhe nënoficer, por edhe punonjës policie me vjetërsi në shërbim minimale, etj, rezultuan debitor, pasi me ligjin e mëparshëm kishin marrë më shumë lek dhe akti normativ i ktheu me shumë pensioni më të ultë dhe për pasojë duhet të kthenin edhe një sasi parash.

"Pas diskutimeve u pa e arsyeshme që nuk është mirë që një njeriu që ka një pension që vërtet rreth minimumit jetik të ndalen edhe disa detyrime, kryesisht për shkaqe të vonësive administrative ose miratimit të dispozitave në kohë të ndryshme", shprehet Emini.

Në këto kushte, vijoi ai u miratua një ligj që falen detyrimet që vijnë për shkak të rilogaritjes. Por, shprehet Emini, nuk falen detyrimet

që janë pasojë e veprimeve të tjera si rasti kur një ushtarak edhe ka punuar edhe ka marrë pension, ose ka punuar dhe nuk është deklaruar që ti kthehet pensioni minimal, por ka marrë një pension që është më i lartë, ose është rikthyer prapë në shërbim, qoftë në polici, ushtri, gardë apo organe të tjera. Këto raste janë raste që kanë dalë debitor dhe që detyrimi i tyre nuk falet.

Mbi bazën e kërkesave të ligjit dhe detyrimeve që përcakton ligji, Këshilli i Ministrave shqyrtoi dhe miratoi një vendim të posaçëm për mënyrën se si do të kthehen paratë e ndalura për ushtarakët dhe se si do pjesa tjetër e detyrimeve që nuk është paguar. Pikërisht përmes vendimit të tetorit është përcaktuar detyrimi që Instituti i Sigurimeve Shoqërore si institucion që administron pensionet të fillojë procedurën e kthimit të detyrimeve. ISSH thotë Emini, ka marrë të gjitha masat dhe po punon intensivisht që të fillojë kthimin duke filluar që nga data 1 nëntor. Është përcaktuar që ato shuma detyrimesh të ndaluara që janë deri në 15 mijë lek, ose në masën e një pensioni minimal të kthehen menjëherë, kurse shumatat e tjera do të kthehen me këste duke fil-



luar që nga muaji nëntor e deri në muajin maj të vitit të ardhshëm", deklaroi Emini. Sipas tij, ish ushtarakëve, këto para do tu kthehen në faturën ku ata marrin pensionin. Aty, shpjegon Emini, tregohet shuma kreditore për shkak të kthimit të detyrimeve dhe aty pensionisti do të shikojë se sa lek ka marrë.

"Asnjë ushtarak nuk ka pse të shkojnë zyrat e sigurimeve shoqërore apo në agjencitë e pritjes së ISSH-së. Ai do të presë ti kthehen paratë që ka paguar deri në fund përmes faturës së pensionit me këste", nënvizon Emini. Janë mbi 5400 ushtarak që do tu kthehen detyrimet dhe ata nuk do të ndërmarrin asnjë lloj veprimi. "Të gjithëve do

tu kthehen paratë një për një në faturë", siguron Emini. Sipas nëndrejtorit të ISSH-së, edhe pasi drejtoritë rajonale të vendosin paratë me këste për ti kthyer, ISSH do të organizojë verifikimin, nëse i kanë bërë veprimet mirë, saktë dhe se a do ti kthehen paratë saktë. Për këtë janë miratuar formate dokumentesh. Asnjë ushtarak nuk ka mundësi të marrë shumën e detyrimeve në mënyrë të menjëhershme, por vetëm me këste. Vetëm në rastet kur përfundon procesi dhe ish ushtaraku mendon se nuk ka marrë shumën e parave të mbajtura atëherë me një kërkese ai duhet ti drejtohet drejtorive rajonale për të bërë rishikim të dosjes së tij. Në një pikë të vendimit të kthimit të parave për ushtarakët përcaktohet se disa ushtarak duhet të bëjnë kërkesë në organet e Sigurimeve Shoqërore dhe në Qendrën e Rekrutimit të Ushtrisë për të marrë formularët e pagave. Ajo kërkesë e vendimit të Këshillit të Ministrave, shpjegon Emini, nuk bën fjalë për këtë kategori ushtarakësh që ju janë bërë llogaritjet dhe ju janë mbajtur lektë. "Ajo bën fjalë për ata ushtarakë që nuk iu janë bërë llogaritjet, sepse nuk kanë sjellë këto lloj formularësh. ISSH ka marrë masat dhe ata ish ushtarakë që kanë mbetur pa sjellë këto formularë, që janë pak persona, rreth 250 persona po njoftohen të kryejnë procedurat", shprehet Emini.

Promovohet libri "Vrasja Tellini" i Andrea Giannasit

Në ambjentet e Auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes, nën kujdesin e veçantë të Komandantit të KDS-së Gjeneral Brigade Dedë Prenga dhe në bashkëpunim me Dhomën e Impreditorëve Italianë u bë promovimi i librit "Vrasja Tellini" i Andrea Giannasi e sjellë në shqip nga Koloneli në rezervë Guri Pashaj. Në këtë aktivitet ishin të pranishëm Zëvendësministri i Mbrojtjes zoti Petro Koçi, Atasheu ushtarak i Republikës së Italisë Kolonel Luciano Palcani, botuesi i librit Luigi Nidito, historiani i shquar Prof. Dr. Pëllumb Xhufi, Profesor Asc. Dr. Bernard Zotaj.



Promovimi i u hap me fjalën e Komandantit të KDS-së i cili bëri një prezantim të shkurtër të veprimtarisë së Gjeneral Enrico Tellinit duke theksuar se Gjeneral Tellini pasi mori detyrën e Kryetarit të Komisionit për Përcaktimin e Kufirit Greko-Shqiptar i ngarkuar nga konferenca Ambasadorëve dhe Lidhja e Kombeve, ai u udhëhoq nga drejtësia dhe ligji ndërkombëtar duke i dhënë me meritë territorin që i takonte Shqipërisë duke u vlarë në një atentat në tokën greke bashkë me grupin e tij. Shqipëria

dhe populli i saj e vlerësuan dhe e çmojnë veprën e Gjeneral Tellinit, përfundon Gjeneral Prenga. Në këtë promovim mbajtën fjalën edhe Profesor Zotaj dhe Prof. Dr. Pëllumb Xhufi të cilët prezantuan dhe paraqitën fakte historike mbi jetën e heroit Gjeneral Tellinit, gjithashtu përshëndeti këtë aktivitet edhe botuesi i librit zoti Luigi Nidito. Dhoma e Impreditorëve Italianë, në përfundim të aktivitetit i dhuroi bibliotekës së AFA-së disa tituj librash historik dhe letrar.



Enrico Tellini (25 gusht 1871-27 gusht 1923), gjenerali italian lindi në Castelnuovo të Garfanjanos, krahinë në lindje të Gjirit të Genova-së, Itali. Mësimet e para i mori në shkollën e vendlindjes, kurse studimet ushtarake i kreu gjatë viteve 1884-1900 në kolegjin e Firénces, në Akademinë Ushtarake, në Torino dhe në Shkollën e Luftës. Gjithnjë me nota "shkëlqyeshëm", në vitin 1890 fitoi gradën nëntoger artilerie. Në vitet 1914-1915 e dërguan atashe ushtarak në ambasadën italiane në Vjenë. Në qershor të vitit 1918 iu dha grada gjeneral brigade; iu besuan detyra në shtabe divizioni, truparmate, në Komandën e Përgjithshme të ushtrisë dhe në Ministrinë e Luftës; komandoi artileri divizionale dhe njëherë pas tjetrës, brigadat "Lombardia" e "Piacenza". Shembullor në kryerjen e detyrave të ngarkuara, e nderuan me Urdhrin "Kryqi i Kalorësit të Urdhrit Ushtarak të Savojës", me "Medalja e Argjend me Vlerë Ushtarake" dhe me "Kryqi i Oficerit të Urdhrit Ushtarak të Savojës". Në përshtatje me aftësitë ushtarake e politike, si dhe me vlerat dhe cilësitë e veçanta njerëzore, më 9 nëntor 1922, Konferenca e Ambasadorëve e zgjodhi kryetar të Komisionit Ndërkombëtar Kufipërcaktues ndërmjet shtetit shqiptar dhe atij grek.

Gjergj Basta (1550-1607) strateg dhe teoricien i shquar ushtarak

Më datën 28 Tetor 2016 në auditoriumin e SHP të FA, Akademia e Forcave të Armatosura në bashkëpunim me një grup historianësh, me rastin e 410 vjetorit të botimit të veprës së parë të Gjergj Bastës dhe të 20 vjetorit të botimit të veprave të tij në gjuhën shqipe zhvilloi sesionin shkencor me temë: "Gjergj Basta (1550-1607) strateg dhe teoricien i shquar ushtarak".

Të pranishëm në sesionin shkencor ishin Zv/ Ministri i Mbrojtjes e RSH zoti Petro Koçi, SHSHP i FA Gjeneralmajor Jeronim Bazo, Komandanti i KDS Gjeneral Brigade Dedë Prenga, Komandantë Forcash, historianë e studjues, atasheet ushtarakë të Gjermanisë dhe Italisë të akredituar në vendin tonë, drejtore të Institucioneve të ndryshme në vend, gjeneralë e ushtarakë në rezervë, drejtorë drejtorie në MM e SHP, pedagogë akademistë etj.

Fjalën e hapjes në sesionin shkencor e mbajti Komandanti/Rektori i AFA Kolonel Ruzhdi Kuçi, i cili vuri në dukje se "...Ky sesion është një nga veprimtaritë shkencore vjetore që organizon Akademia e Forcave të Armatosura. Prej muajsh kemi punuar për të përgatitur një sesion të denjë shkencor për një figurë të tillë si ajo e Gjeneral Gjergj Bastës qoftë si komandant dhe pjesëmarrës i drejtëpërdrejtë në betejë, qoftë si teoricien dhe njohës i jashtëzakonshëm i artit luftarak të kohës kur jetoi e veprimi..."

Sesioni shkencor u drejtua nga historiani Prof. Dr. Pëllumb Xhufi. Referati "Gjergj Basta, strateg dhe teoricien i shquar ushtarak" u mbajt nga Kolonel (R) Sali Onuzi. Profesor Pëllumb Xhufi mbajti kumtesën mbi "Origjinën shqiptare të dinastisë së Bastajve". Sesioni shkencor vijoi me kumtesën e përgatitur nga Dr. Marenglen Kasmi "Gjergj Basta në historiografinë europiane/ gjermane".



Kumtesa mbi veprat e Gjergj Bastës "Mjeshtër i Përgjithshëm i Kampit" u mbajt nga N/Kolonel Msc. Edmond Doda. Prof. Asc. Dr. Bernard Zotaj mbajti kumtesën mbi veprën e Bastës "Drejtimi i Kalorësisë së lehtë".

Në sesionin shkencor përshëndeti edhe Komandanti i Komandës së Doktrinës dhe të Stërvitjes Gjeneral Brigade Dedë Prenga, i cili në fjalën e tij falënderoi "...në emër të Ministres së Mbrojtjes, Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA grupin iniciues, në veçanti historianin Pëllumb Xhufi dhe lektorët që sollën me profesionalizëm kumtesat e tyre në plotësimin e figurës së plotë të Gjergj Bastës. Gjithashtu falënderoi botuesin dhe përkthyesen e veprës së Bastës Prof. Dr. Eljana Paço e cila 20 vjet më parë solli veprën e Bastës në gjuhën shqipe..." Në fjalën e mbylljes Prof. Dr. Pëllumb Xhufi dhe Komandanti i AFA Kolonel Ruzhdi Kuçi falënderoi lektorët dhe pjesëmarrësit për pjesëmarrjen e tyre në sesionin

shkencor.

Pak fjalë për Gjeneralin e shquar mbarë evropian me Origjinë shqiptare Gjergj Basta (1550-1607)

Gjergj Basta është gjenerali i famshëm me origjinë shqiptare, evropian me origjinë shqiptare, i biri i një fisniku shqiptar, Dhimitër Bastës, nga qyteti i Bastjes, një qytet afër Sarandës së sotme.

Gjergji lindi në Roccaforzata (Taranto) Itali më 1550. U shkollua në Austri dhe në një Shkollë Ushtarake në Hollandën spanjolle. Kish hyrë në rradhët e stratotëve shqiptarë (mercenarë) që në moshën 15 vjecare. Më 1579 është Komisar i Përgjithshëm i Kalorësisë Spanjolle në vendet e ulëta. Shquhet për një seri betejash në Flander, në Francë, në Gjermani.

Në vitin 1593 vihet në shërbim të

kundër ekspansionit osman në Europën Qëndrore (Danubi i Mesëm). Në krye të korpusit spanjoll që kish ardhur në ndihmë shquhet për shumë betejë.

Më 1598 dërgohet në Transilvani. Më 1602 emërohet Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë së perandorisë gjermane në Hungarinë e sipërme me gradën gjeneralfeldobristen (Feldmarshall) dhe 1605 i jepet titulli i kontit perandorak. Gjithashtu ishte emëruar guvernator dhe mëkëmbës i perandorit në Transilvani dhe në Hungari.

Pas nënshkrimit të traktatit të Paqes mes habsburgëve dhe osmanëve (11 nëntor 1606) u largua nga ushtria ku kishte shërbyer për 40 vjet dhe kishte marrë pjesë e kishte komanduar 100 betejë.

Pas largimit nga ushtria shkruajti shkrime e traktate ushtarake. Më 1606 botohet në Venecia "Il maestro di campo generale" (Mjeshtri i Përgjithshëm i Kampit); më 1610 u botua "Il governo della cavaleria leggiera" (Drejtimi i kalorësisë së lehtë) vepra që janë çmuar. Madje kjo e fundit si gjennale.

Gjergj Basta zë një vend të merituar si filozof i çështjeve të përgjithshme të luftës dhe si teoricien i parë i Europës moderne që përcaktoi rregullat e kalorësisë së lehtë. Basta zotëronte 6 gjuhë.

Dy veprat e tij "Mjeshtër i Përgjithshëm i kampit" dhe "Drejtimi i kalorësisë së lehtë" janë përkthyer dhe botuar në shumë gjuhë të Europës dhe në gjuhën shqipe në vitin 1996 nga Prof. Dr. Eljana Paço. Gjergj Basta vdiq më 1607 dhe u varros në Vjenë.



Rudolfit të II, perandor i perandorisë së shenjtë të kombit Gjerman, dhe merr pjesë në luftën "e gjatë" 13 vjecare



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTA

Gjergj Basta për drejtimin e kalorësisë së lehtë

Gjenerali Gjergj Basta në fushën e luftës u nis nga studimi i dukurive dhe i fenomeneve ushtarake, për të shkruar teori ushtarake dhe për t'u lënë ushtrive dhe udhëheqësve të tyre tri vepra, të cilat u ribotuan në italisht dhe më tej në frëngjisht, në spanjisht e në gjermanisht. Rregulloret "Udhëheqësi i veprimeve të përgjithshme luftarake", "Drejtimi i kalorësisë së lehtë", "Mbi drejtimin e artillerisë" u cilësuan vepra themeltare, mbi bazën e të cilave u ndërtuan dhe funksionuan ushtritë tri armëshe të kohës që janë.

Në letërsinë ushtarake evropiane "Drejtimi i kalorësisë së lehtë" çmohet madhore. Ajo ka zënë vend si rregullorja e parë e organizimit të kalorësisë së lehtë. Me këtë veprë Basta konfirmoi kalorësinë famëmadhe arbëreshe, të cilën autorë francezë, analistë gjermanë deduktonin se "Arbëreshët kërkoheshin e vlerësoheshin shumë në ushtritë evropiane" në shek. XV-XVI. "Kjo veprë, parathuhet në kapak, është një traktat ushtarak origjinal i shkruar nga Gjergj Basta, e dobishme për ushtarët dhe për luftëtarët, e frytshme për kapitenët".

Të jepje e të mbaje në ushtri, por dhe në beteja një promemorie orinetuese, në atë kohë ishte një përjashtim, një dukuri e mirëpritur. Të katër pjesët e kësaj veprë ishin një sintezë teorike-përgjithësuese e fakteve, ngjarjeve, luftimeve, personazheve etj., në mënyrën e drejtimit të kalorësisë, në ngritjen dhe përpunimin e një art ushtarak, në njohjen e jetës së luftës, të përpunuar e të përjetuar nga strategu, si dhe mbresa e emocione si luftëtar e si mendimtar.

Pjesa e parë trajton jetën e rëndë ushtarake, detyrat e vështira, përdorimin mjeshhtëror të armëve e të pajisjeve mbrojtëse dhe dashurinë e përkujdesin ndaj kalit që nga ushtari i thjeshtë deri te gjenerali. Kuajt zgjidheshin më të mirët, ata më me vlerë sikur të ishin njëllor si njerëzit, si kalorësit. Gjergj Basta me vizionin e tij prej ushtaraku ju ka bërë një vlerësim përvojës së kalorësive më të përparuar ushtrive më të mira të kohës. Vendet e Ulta si Franca, Gjermania, Spanja, Hungaria, Turqia ishin shembujt e zgjedhur, duke i krahasuar dhe arritur në përfundime për çdo detaj të këtij mekanizmi të çuditshëm, por të bukur, siç ishte kalorësia. Si vërtetues dhe interpretues i qindra rasteve mbetet në fuqi pikëpamja e tij se, vetëm me një stërvitje të kualifikuar, ushtria sapo përleshet trup me trup me armikun, i shkakton atij humbje shumë të mëdha. Dukuri e përhershme e tyre ishte kacafytja e shpejtë, domethënë ta ndezësh mirë përleshjen, pastaj të tërhiqesh nga sheshi i betejës me t'u dhënë sinjali. Qëndrimi i luftëtarit në kalë prek me gjuhë gati qemerin e shalës, duke u mbledhur krejt, apo i bërë njësh me kalin.

Pjesa e dytë trajton problemet e shpërndarjes dhe disiplinën e ushtarëve nëpër fshatra gjatë luftimit. Duke rreptësuar moslëvizjen asnjë hap nga pozicioni pa urdhër, ushtaraku i sprovuar me fitore e hidhërima konkrete, rekomandon këshilla si "nga vendi i caktuar për luftim, kalorësi duhet të lëvizë vetëm atëherë kur oficeri do të lajmëronte me anën e katër apo gjashtë kalorësve, të



cilët do të sillnin urdhërin".

Basta shfaqti aftësi si strateg ushtarak duke qenë i qetë, i paepur, në marrjen e masave për vigjilencë, i siguron njerëzit, u ngre moralin, bën planin e çarjes së rrethimit edhe në mes të natës. Mbledh kolonellët, asgjëson e djeg krejt bagazhin e rëndë, i lehtëson ushtarët nga pesha e armatimit dhe shpërthen rrethimin duke zënë lartësitë me shpejtësi e në heshtje të plotë, në mes të natës. Shpërthen sulmin dhe arrin fitore, duke humbur vetëm 200 luftëtarë, ndërkohë që kundërshtari humbet 12 mijë veta. Basta sheh në këtë fitore të veçantë, në kulmin e dëshpërimit të ushtrisë, dorën e Perëndisë. Kalorësit e Bastës asgjësonin në një kohë të shkurtër gjithë pasurinë e grumbulluar të kundërshtarit. Ndaj dhe për disa javë me radhë, venedikasit regjistruan lajme marramendëse, ku thuhet se vlera e plaçkës arrinte në qiell.

Interesant është fakti, se Gjergj Basta kishte kurajon të citonte gabimet e tij dhe pasojat, sidomos për marrshimet që shtjellohen në pjesën e tretë. Marrshimet ishte lënda ku përshkruhen dhimbjet dhe kënaqësitë e luftimit për të hyrë në luftë i organizuar, me dinjitet dhe për fitore. Errësira e natës dhe kalimet në terrene të vështira, për teoricienin - strateg, mbartin vlera befasuese, dobiprurëse të pallogaritshme. Dy llojet e rreshtimit, në formë hëne e gjysëm hëne, në e

curinë e betejave, janë lënda e pjesës së katërt mbyllëse të veprës.

Vepra e Gjergj Bastës përshkohet nga analiza dhe konkluzione, shpirti i një mendjeje gjeniale. Artin e të luftuarit ai e dëgjoi nëpër këngë e tregime në mjedis arbëreshe, atë të farefisit, e pa dhe e mësoi me të atin, mësues, e përvetësoi dhe e lartësoi në fushëbetejë, e studioi dhe e shndërroi

Vepra e gjeneral Gjergj Bastës është nga të parat që kodifikoi parimet dhe elementet e luftimit të këmbësorisë e të kalorësisë, u përkrah fuqishëm nga kancelaritë ushtarake, nga historianët, nga komandantët dhe nga ushtritë e të gjithë Evropës. Teoria e tij përmbysi doktrinën klasike, të rëndë, të pamanovrueshme, duke e freskuar dhe gjallëruar mendimin e praktikën luftar-



të babait, të vëllait Nikoll, të komandantëve shumëkombësh. Si njohës i përkryer i artit ushtarak, i talentuar për të penetruar në sferën e përpunimit, Gjergj Basta shpjegon detaje të thjeshta duke mbaruar në të ndërlikuarat gjatë formulimit dhe përshkrimit të çdo teze. Pasqyrimi tri dimensional me syrin kritik, me një gjuhë të kuptueshme e koncize, me shembuj konkret dhe personazhe të paimprovizuar, i japin veprës së tij një tipar tjetër dallues e të respektuar.

Dukuria e Bastës ishte shprehja e cilësive dhe e tipareve të natyrës shqiptare, që përputhen me shpirtin e tij të energjisë dhe të karakterit të vendosur, me zotësinë e tij ushtarake dhe cilësitë organizative, sikurse dëshmon Prof. Çabej. "Zotësia ushtarake është e lindur prej kësaj race, ajo i ka ngjitur shqiptarit vullën e ushtarit të përjetshëm. Natyra e ushtarit është një trajtë e përbashkët karakteri, një atribut konstant i këtij kombi". Ndër vetitë fiziko-morale-ushtarake veçojmë, trimërinë apo kreshnikërinë e tij, ndershmërinë në aleanca, zellin dhe besnikërinë në të shërbyer, nuhatjen e rrezikut dhe të situatave të ndërlikuara, sidomos në shesh të luftës, hollësinë dhe praninë e jashtëzakonshme të mendjes, kurajon e lindur nga jeta me rreziqe, marrjen e nismës së fortë në çastin dhe në vendin e duhur.

Teoricieni dhe strategu i ardhur nga Shqipëria rrëmbeu mendjet e zemrat, adhurimin e konsideratat e mijëra simpatizantëve e komandantëve bashkëkohës, të mjaft personaliteteve me zë pasardhës të Evropës. Vlerësimet për të janë të shumta dhe të larmishme. Ato japin portretin e plotë të Gjergj Bastës.

Në mjaft "Enciklopedi Ushtarake" të Evropës, jepet e njëjta sentencë: "Gjergj Basta ishte gjeneral... me origjinë shqiptare... Është marrë edhe me letërsi ushtarake... Më i rëndësishëm është traktati "Drejtimi i kalorësisë së lehtë... Kjo veprë... mund të cilësohet si pararendës e letërsisë së mëvonshme për luftimin e vogël".

Kardinali G. Bentivoglio që shërbeu nëntë vjet në Vendet e Ulëta ku strategu shpalsi madhësinë, e quan Bastën "Gjeneral të kalorësisë dhe një komandant i madh".

Studiues të apasionuar nga Franca të Bastës japin mirënjohje të veçanta për teoricienin. Kështu, dy autorë të dëgjuar të artit ushtarak francez, G. Node - P. Bail, nënvizojnë: "Në veprat e shkruara nga Gjergj Basta gjendet shkëlqimi i shprehjes dhe kriteri i sigurt i një udhëheqësi ushtarak të sprovuar". Francezi i tretë Zh. Sh. Folardi biograf: "Gjergj Basta ka qenë njeri nga kapitenët dhe burrat më të mëdhenj të kalorësisë së shekullit të tij dhe njëheri autor teorik i çmuar".

Dukuria Basta ishte shprehje e artit të lashtë ushtarak shqiptar, përsosur në periudhën e Skënderbeut, ishte kontribut me vlerë në artin ushtarak evropian duke futur në të për herë të parë, taktikën dhe strategjinë e kalorësisë së lehtë shqiptare, sintetizuar në veprat e komisarit të përgjithshëm të kalorësisë, shqiptarit Gjergj Basta.

në teori në luftë e pas saj. Një testament, dëshmi e pa konstatueshme e gjenisë krijuese e një mendimtarit të shuqar, siç ishte kujtimi dhe nderimi i emrit simbol të Gjergj Kastriotit - Skënderbeut u përligj.

ake me një teori të çliuar nga kornizat e ngurta të sistemit ushtarak feudal. Basta përgjithësoi një epokë.

Në bosht të veprës së tij vuri talentin triumfues të Skënderbeut, përvojën me bollëk të bashkëluftëtarëve arbëreshë,

MIMOZA GOLIKJA

NATO nuk kërkon konfrontim me Rusinë

Ministrat e Mbrojtjes të NATO-s përfunduan takimin dy ditor në Bruksel, më 26-27 tetor 2016, për të çuar përpara vendimet e marra në korrik në Samitin e Varshavës. Ata shënuan progres në lidhje me praninë e Përforuar të NATO-s në pjesën lindore të Aleancës dhe në rajonin e Detit të Zi, si dhe diskutuan aktivitetin e fundit ushtarak të Rusisë përgjatë kufijve të NATO-s. Ministrat u fokusuan gjithashtu në përpjekjet e NATO-s për të projektuar stabilitet përtej kufijve të saj. Ata shqyrtuan progresin në Trajnimin e NATO-s dhe ngritjen e kapaciteteve për Irakun. Ministrat diskutuan të ardhmen e dislokimit të Aleancës në detin Egje dhe e konsideruan një rol të mundshëm detar për NATO-n në Mesdheun Qendror, që mund të mbështesin operacionin Sofia të BE-së.

Progres në parandalimin dhe forcimin e mbrojtjes të NATO-s

“Gjatë dy ditëve, ne kemi vlerësuar sfidat e ndryshme me të cilat përballet NATO”, tha Sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg. “Ne shënuam aksionet e progresit tonë që nga Samiti i Varshavës, dhe hartuam rrugën përpara. Ne jemi të bashkuar si kurrë më parë në vendosmërinë tonë për të mbrojtur qytetarët tanë”.

Në takim u diskutuan masa për të forcuar sprapsjen dhe mbrojtjen e NATO-s, përfshirë vendosjen e katër batalioneve shumëkombëshe në lindje të Aleancës në fillim të vitit 2017, të udhëhequr nga Kanadaja, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara. Sekretari i Përgjithshëm tha se plani është në rrugën e duhur, dëshmi e qartë e “një demonstrimi transatlantik të mbështetjes shkëmb të fortë për aleatët tanë”. “Aleancën bën atë që thotë. Ne i pëmbushim premtimet tona”. Ministrat konsideruan progres në praninë e NATO-s në rajonin e Detit të Zi, e përbërë nga një brigadë shumëkombëshe e udhëhequr nga Rumania. Ata theksuan rëndësinë kiber në operacionet e NATO-s dhe diskutuan kërkesat e reja të Strukturës së Komandës së NATO-s.

Një tjetër temë diskutimi e rëndësishme ishte se si NATO mund të rrisë përpjekjet për projektin e stabilitetit në rajonin e saj. Në kontekst, ministrat ranë dakord mbi ngritjen e kapaciteteve të forcave të armatosura të Irakut si dhe mbështetjen trajnimin ekzistues të zyrtarëve irakianë në Jordani. Sekretari i Përgjithshëm e quajti misionin e zgjeruar trajnim “për kontribut të rëndësishëm në luftën kundër ISIS”.

Në diskutimin mbi operacionin detar të Rojes Bregdetare të NATO-s, u diskutua mbi më shumë suport për Operacionin Sofia të BE-së, duke siguruar ndërgjegjësimin e situatës dhe mbështetje logjistike. NATO do të ketë anije dhe avionë patrullimi detar në dispozicion për të ndihmuar Operacionin Sofia në Mesdheun qendror brenda dy javësh. Duke e quajtur këtë bashkëpunim “edhe një shembull të NATO-s dhe BE, dorë më dorë, që punon për të rritur sigurinë e Evropës”, Sekretari i Përgjithshëm theksoi rëndësinë e dy organizatave në zhvillimin e lidhjeve më të ngushta. Ai komentoi mbi iniciativat e fundit për të forcuar mbrojtjen evropiane, duke theksuar këtë për aq kohë sa të dyja kërkojnë për të plotësuar dhe mos kopjuar njëri-tjetrit, “një Evropë e fortë do të bëjë NATO të fortë”.

Mbi bashkëpunimin NATO-BE

Ministrat e Mbrojtjes të vendeve aleate diskutuan hapa praktikë për të marrë përpara në bashkëpunimin e NATO-s me Bashkimin Evropian në ditën e dytë të takimit të tyre. Takimit të ministrave iu bashkuar Përfaqësuesi i Lartë i BE-së



Federica Mogherini, si dhe ministrat e Mbrojtjes së Finlandës dhe Suedisë.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg theksoi përfitimet e bashkëpunimit më të ngushtë NATO-BE. Ai vuri në dukje se, në Detin Egje, dislokimi i NATO-s mbështet Greqinë, Turqinë dhe agjencinë e kufijve Frontex të BE-së në thyerjen e linjave të trafikimit të qenieve njerëzore. “Kjo është arsyeja pse ne vendosëm që të vazhdojmë vendosjen tonë në Egje”, tha Stoltenberg. Aleatët vendosën mbi Operacionin e ri të Rojes Bregdetare të NATO-s dhe më shumë suport për Operacionin Sofia të BE-së. Brenda dy javësh, anijet dhe avionët e NATO-s do të jenë në Mesdheun Qendror, të gatshëm për të ndihmuar në rritjen e ndërgjegjësimin të situatës së BE-së dhe të ofrojnë mbështetje logjistike.

Ministrat adresuan mënyrat për të thelluar bashkëpunimin NATO-BE në fushat kundër kërcënimeve hibride, mbrojtjes kibernetike, ushtrime të koordinuara me partnerët mbështetës. Ministrat diskutuan iniciativat e fundit për të forcuar mbrojtjen evropiane. Sekretari i Përgjithshëm theksoi se një Europë e fortë do të bëjë NATO-n të fortë, sidomos duke dhënë më shumë aftësi dhe duke rritur shpenzimet e mbrojtjes në mes të aleatëve evropianë.

NATO e bashkuar si kurrë më parë

Pas takimit të Këshillit të Atlantikut të Veriut në nivelin e Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s, Sekretari i Përgjithshëm, Jens Stoltenberg, dha një konferencë për shtypin.

“Ne përfundam një takim të frytshëm të ministrave të Mbrojtjes të NATO-s që trajtuam parandalimin dhe mbrojtjen si dhe se si po shkojmë përpara për të zbatuar vendimet që kemi bërë në Samitin e Varshavës. Mbrojtja jonë për pothuajse një miliardë qytetarët është përgjegjësia kryesore e NATO-s. Në Samitin e Varshavës në korrik, udhëheqësit e NATO-s morën vendim për të siguruar që ne të vazhdojmë të bëjmë këtë. Gjatë 100 ditëve të fundit, ne kemi bërë një rrugë të gjatë në zbatimin e këtyre vendimeve. Sot ne vlerësuam se sa larg kemi shkuar dhe punën që na mbetet përpara. Këtë vit, Kanadaja, Gjermania, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara, secili janë të përkushtuar për të udhëhequr një

batalion shumëkombësh në pjesën lindore të Aleancës. Një demonstrim transatlantik i mbështetjes shkëmb të fortë për aleatët tanë.

Jam krenar për të njoftuar se shumë aleatë të tjerë konfirmuan kontribute të forcave të sintezës sot. Shqipëria, Italia, Polonia dhe Sllovenia do të kontribuojnë në batalionin e udhëhequr nga Kanadaja në Letoni. Belgjika, Kroacia, Franca, Luksemburgu, Holanda dhe Norvegjia do të bashkohen me batalionin e udhëhequr nga Gjermania në Lituani. Danimarka dhe Franca do të kontribuojnë në batalionin e udhëhequr nga Mbretëria e Bashkuar në Estoni. Dhe Rumania dhe Mbretëria e Bashkuar do të bashkohen me batalionin e udhëhequr nga SHBA në Poloni.

Forcat tona do të jenë me të vërtetë shumëkombëshe, do të dërgojnë një mesazh të pagabueshëm: NATO qëndron si një. Një sulm ndaj çdo aleati do të konsiderohet si sulm mbi të gjithë ne.

Në Varshavë, kemi thënë se pritet të vendosim katër batalione në fillim të 2017. Unë jam i kënaqur për të konfirmuar që po e bëjmë këtë, ne jemi në rrugën e duhur. Kjo Aleancë bën atë që thotë. Ne mbajmë premtimet tona. Ne diskutuam progres në forcimin e pranisë së NATO-s në rajonin e Detit të Zi, me një strukturë të brigadës shumëkombëshe në tokë të udhëhequr nga Rumania. Jemi duke punuar për masat në ajër dhe në det. Jam i kënaqur për të konfirmuar atë që bënë disa vende që treguan gatishmërinë e tyre për të kontribuar në praninë tonë në rajonin e Detit të Zi, në tokë, në det dhe në ajër, duke përfshirë Kanadanë, Gjermaninë, Holandën, Poloninë, Turqinë dhe Shtetet e Bashkuara. Aleatët e tjerë janë në kërkim në mënyrën se si ata mund të kontribuojnë. Gjatë takimit, kemi diskutuar veprimtarinë ushtarake të kohëve të fundit në kufijtë e NATO-s. Duke përfshirë ushtrimin e fundit Kavkaz 2016, dhe vendosjen e Rusisë të sistemeve të raketave Iskander në Kaliningrad. Ne jemi të shqetësuar në lidhje me sjelljen e Rusisë. Por dialogu është edhe më i rëndësishëm kur tensionin janë të larta dhe aleatët janë të gatshëm për të mbajtur një takim të ambasadorëve të Këshillit NATO-Rusi në të ardhmen e afërt.

Ne diskutuam rolin në rritje të mbrojtjes kibernetike për NATO-n. Në Varshavë, aleatët u zotuan për të forcuar mbrojtjen e tyre kombëtare kibernetike. Ne e theksuam rëndësinë e asaj që kemi bërë mirë në premtim e mara kështu atë që kemi bërë ne mund të tregojmë me rezultate konkrete në Samitin tonë të ardhshëm.

Më në fund, sfidat e reja të sigurisë mund të thonë kërkesa të reja në strukturën tonë komanduese. Ajo duhet të jetë e fortë dhe më e shkathët, fuqizimin e Aleancës për të vazhduar për të marrë veprim të shpejtë dhe vendimtar. Pra, ne kemi vendosur për të mbledhur një Grup të Ekspertëve të lartë për të mbështetur Komandantët Strategjikë duke vlerësuar efektivitetin e Strukturës së Komandës së NATO-s. Ne diskutimet në këtë takim jam i inkurajuar nga progresi që ne jemi duke bërë, të udhëhequr nga vendimet e marra në Samitin e Varshavës. NATO është përshtatur për të ardhmen, për të mbajtur njerëzit tanë të sigurt dhe Aleancën tonë të fortë”.



Mund të na shtjelloni pak më shumë lidhur me masat me Rumaninë, pikërisht në përputhje me vendimet e marra në Samitin e Varshavës?

Jemi në proces të Vendimit, në formën dhe dizajnin e pranisë përshatur në jug lindje të Aleancës dhe disa vende njoftuan sot, se ato janë të gatshme të kontribuojnë në forcat dhe aftësitë, për të rritur praninë tonë në ajër, në det dhe në tokë dhe shumë

elemente janë rënë dakord, por ne jemi duke punuar në paketën e plotë të masave dhe kemi për qëllim që të jemi në gjendje për të paraqitur dhe për të rënë dakord dhe për të përfunduar, në takimin tonë ministror të mbrojtjes në shkurt. Pra, ajo çfarë mund të them, është se puna e bërë po ecën mirë. Disa aleatë njoftuan sot se janë të gatshëm të ofrojnë lloje të ndryshme të forcave, por të gjitha elementet ende nuk janë vendosur plotësisht. Pra, disa punë mbeten për t'u bërë. Kanadaja dhe Gjermania, Holanda, Polonia, Turqia dhe Shtetet e Bashkuara njoftuan gjatë takimit se ato do të kontribuojnë në praninë tonë të rritur, apo të rritura ose të përshtatur përpara në jug lindje të aleancës.

Mund të na sqaroni, ju lutem për shefin e sapoemëruar të inteligjencës? Pse ky person, saktësisht është zgjedhur për këtë detyrë, a ka ai një ekip dhe kur do të fillojë nga puna?

Ne jemi ballafaquar me një mjedis të ri dhe më të kërkuar të sigurisë me gjithë dhunën e paqëndrueshmërinë në jug me ISIS, me trazira në Afrikën e Veriut, Lindjen e Mesme dhe kjo ka pasoja të drejtpërdrejta për aleatët e NATO-s, për shkak se është afër kufijve të NATO-s, në afërsi të Turqisë, por ne gjithashtu shohim se disa nga këto dhuna, disa nga këto trazira kanë frymëzuar edhe sulme terroriste në vetë rrugët tona. Në të njëjtën kohë ne po përballemi me një sfidë shumë të ndryshme me Rusinë më të sigurt, e cila gjithnjë është duke rritur praninë e saj ushtarake në afërsi të kufijve të NATO-s. Pra, e gjithë kjo, tregon një mjedis më të kërkuar të sigurisë, rrit nevojën për ne për të kuptuar dhe për të vlerësuar sfidat me të cilat po ballafaqohemi, të reagojmë në një mënyrë proporcionale, të përgjegjshme, prandaj dhe inteligjencia është bërë edhe më e rëndësishme. Grumbullim të inteligjencës, ndarje të inteligjencës, por gjithashtu sigurisht, për të kuptuar inteligjencën.

Kjo është arsyeja pse ne kemi vendosur për të krijuar një ndarje të re brenda NATO-s, e cila është dedikuar

për inteligjencën dhe ndarja e re do të drejtohet ose udhëhiqet nga një Ndhimës Sekretar i Përgjithshëm Inteligjence ose për Inteligjencën. Kam caktuar një gjerman. Ai ka një karrierë të gjatë të Shërbimit të Jashtëm të Gjermanisë, por edhe nga shërbimet e tyre të inteligjencës. Kështu që unë e konsideroj atë si shumë të përshatshëm për detyrën. Unë jam duke kërkuar përpara për të punuar me të dhe ai dëshiron të fillojë brenda një kohe jo shumë të gjatë, por unë nuk jam



Përfaqësues të OSBE vizitojnë Bazën Ajrore Farkë

Në Bazën Ajrore Farkë u zhvillua ditën e mercurë date 2 nëntor aktiviteti "Vizitë në Bazën Ajrore dhe infrastrukturën ushtarake". Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të zbatimit të Dokumentit të Vjenës (DV-11), me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga vende anëtare të OSBE. Qëllimi i kësaj vizite ishte inspektim për in-

frastrukturën ushtarake dhe teknikën ajrore në Bazën Ajrore Farkë. Në ambientet e Bazës, përfaqësuesit e këtij ekipi u pritën nga zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Flamur Hadushi dhe komandanti i Bazës Ajrore Farkë, kolonel Kuto Hasani. Fillimisht, përfaqësuesit e vendeve anëtare të OSBE nëpërmjet dy bfringjeve u njohën me misionin dhe

detyrat e Forcës Ajrore në përgjithësi dhe me ato të Bazës Ajrore, Farkë, në veçanti. Vizita vijoi me inspektimin e infrastrukturës, mjeteve ajrore ushtarake, si dhe demonstrime ajrore. Gjatë ekspozimit të teknikës ajrore ekipi u njoh nga personeli pilot dhe teknik të mirëmbajtes për versionet e përdorimit të kësaj teknike. Nga ekipazhet fluturuese në bashkëpunim

me Forcat Speciale u kryen demonstrime ajrore. Këto demonstrime ishin me tematikë nga një situatë reale të kërkim-shpëtimit (SAR) dhe një situatë reale të infiltrimit të një grupi të Forcave Speciale nga ajri me teknikën Fast Roping në një zonë operacionale. Nga grupi i Forcave Speciale bëhet thirrja për transportin CASEVAC të plagosurve gjatë luftimit.

Në përfundim të vizitës përfaqësuesit e vendeve të OSBE u takuan për konkluzionet e vizitës. Ata falënderuan për mikpritjen dhe prezantimin dinjitoz që iu rezervua, si dhe falënderuan për demonstrimin ajror që paraqiti aftësitë operacionale të Forcës Ajrore. Vizita u mbyll me shkëmbim dhuratash dhe më një foto të përbashkët.

në gjendje tju jap një datë të saktë, por ai, dëshiron të jetë në NATO sa më shpejt që të jetë e mundur. Pra, atëherë, ne do të jemi në gjendje për të forcuar dhe për të përmirësuar mënyrën se si të punojmë në inteligjencën në NATO dhe kjo është gjithashtu e rëndësishme sepse kjo është e lidhur gjithashtu me mënyrën se si ne do të mbështesim dhe do të ndihmojmë vendet për të punuar mbi inteligjencën.

Ministri i Mbrojtjes i Italisë kërkoi një rol të madh të komandës së përbashkët në Napoli. Çfarë prisi ju në krahun jugor të aleancës?

Së pari, unë mendoj se është e rëndësishme të theksohet se ajo që NATO bën gjithmonë ka një qasje të 360 gradë, që do të thotë se kur ne për shembull, të rrisim gatishmërinë e forcave tona, kur ne tashmë kemi krijuar gatishmërinë e lartë në forcën e re të posaçme të përbashkët, Brigadën, dhe kur ne kemi trefishuar madhësinë e forcës së reagimit të NATO-s në 40.000 trupa, që është e rëndësishme si për në lindje dhe për në jug.

Kjo nuk është diçka që është caktuar për në lindje. Ajo është e rezervuar për përgjigjet ndaj çdo kërcënimi nga çdo drejtim drejt NATO-s. Pra, ajo është gjithashtu e rëndësishme për në jug, në gatishmërinë e lartë të task forcës të re të përbashkët dhe rritjen e forcës së reagimit të NATO-s. Së dyti, ne kemi trajtuar disa çështje të cilat, unë duhet të them, janë pjesë e reagimit tonë ndaj sfidave që shohim në jug.

Ne kemi rritur praninë tonë në Turqi me masat e sigurimit në Turqi dhe unë e mirëpres që Italia është duke kontribuar me një bateri kundër-raketore SAMP / T, që është e rëndësishme dhe kjo është një nga shembujt se si kemi rritur praninë tonë në jug me rritjen e pranisë së NATO-s në Turqi. Ne do të diskutojmë çështje në mënyra të tjera të cilat janë shumë të rëndësishme për Italinë dhe Jugun. Ne kemi diskutuar krijimin e Rojes Bregdetare, misionin e ri detar të sigurisë së NATO-s në Mesdhe dhe ne do të trajtojmë se si Roja Bregdetare mund të sigurojë ndihmë dhe mbështetje për operacionin Sofia të BE-së, do të meren vendime dhe pastaj do të jem në gjendje për të njoftuar. Atëherë mund t'ju them më shumë. Dhe gjëja e fundit që ne drejtuam është, natyrisht, se si ne mund të japim mbështetje për koalicionin kundër-ISIS. Ne kemi filluar të ofrojmë mbështetje të drejtpërdrejtë me avionë të vëzhgimit AWACS të NATO-s. Që filloi javën e



kaluar më 20 tetor dhe ne për këtë arsye jmi në procesin e marrjes së vendimeve në trajnimin e zyrtarëve irakianë brenda Irakut. Ne i kemi trajnuar ata në Jordani për një kohë, por tani jemi duke lëvizur në Irak dhe për këtë arsye ne do të marrim vendime sonte.

Si mendoni për përforcimet e reja të Rusisë për të shtuar flotën e saj Baltike pranë Kaliningradit? Ka disa raporte që vijnë nga mediat ruse, një konfirmim tuajin për këtë. Ministri polak i mbrojtjes tha këtu, në këtë takim se kjo ndryshon balancën e pushtetit në dhe rreth Kaliningradit. Cili është mendimi juaj për aftësitë bërthamore që mund të jenë atje tani dhe shqetësimi juaj pasi thuhet se dy luftanije të reja kanë marrë atë drejtim?

Unë mund të konfirmoj se dy luftanijet ruse kanë hyrë kohët e fundit në Detin Baltik dhe NATO është duke monitoruar këtë lëvizje në mënyrë që gjithmonë të veprojmë në mënyrë të përgjegjshme dhe të matur; por ne jemi, natyrisht, gjithmonë duke ndjekur këtë lloj të lëvizjes dhe vendosjes e forcave detare ruse ndërsa ne, për shembull, tani edhe të monitorojmë lëvizjen e grupit transportues aeroplanësh Kuznetsov në Mesdhe. Por në të njëjtën kohë, unë mendoj se ne duhet të kuptojmë se ky është gjithashtu pikërisht një shembull i modelit që ne kemi parë gjatë një periudhe të gjatë kohore, ku shohim më shumë aktivitet ruse, shohim ndërtimet ushtarake ruse, shohim gjithashtu dhe më shumë ushtrime ruse me shumë lloje të ndryshme të aftësive.

Unë mendoj se është e rëndësishme që NATO të ketë një qasje strategjike për të kuptuar se ne nuk duhet ta lidhim me çdo ngjarje, por kanë të bëjnë me pamjen e përgjithshme. Dhe kjo është arsyeja pse NATO ka reaguar dhe pse NATO po i përgjigjet me rritjen e gatishmërisë së forcave tona, me rritjen e prezencës edhe në rajonin e Balltikut dhe me seli të vogla në pjesën lindore të aleancës për të qenë në gjendje të planifikojmë ushtrime, për të koordinuar përpjekjet e forcave të mbrojtjes kombëtare në vend dhe forcave të NATO-s dhe përforcimet e mundshme. Pra, e gjithë kjo është pjesë e një foto të cilës NATO i është përgjigjur dhe që ne do të vazhdojmë për t'iu përgjigjur. Për mua, është e rëndësishme që të reagojmë për këtë në një mënyrë të matur dhe të përgjegjshme dhe të theksoj se ajo që NATO bën në rajonin e Balltikut, por edhe në juglindje të aleancës është mbrojtëse; ajo është proporcionale dhe kjo është plotësisht në përputhje me angazhimet tona ndërkombëtare.

Cili është afati i vendosjes për batalionet dhe çfarë armësh do kenë?

E pra, vendimi që kemi bërë në korrik ishte për të filluar vendosjen e hershme në 2017, në fillim të vitit të ardhshëm, dhe pastaj të vendosen plotësisht në verë dhe ky është ende plani dhe ne jemi në rrugën e duhur dhe jemi duke ecur në bazë të këtij plani. Dhe në fakt, unë jam shumë i frymëzuar nga takimi sot. Për shkak se kaq shumë vende kanë marrë vendime shumë të forta dhe konkrete dhe njoftimet mbi kontributet në katër batal-

ionet, kështu ato do të jenë të fuqishme, do të jenë multi-nacionale dhe do të jenë gati për luftë. Ato nuk do të jenë të njëjta në katër vende të ndryshme, por mund të them se ato do të jenë të fuqishme, do të jenë gati për betejë dhe batalionet do të përforcohen në mënyrë që të japin një mesazh shumë të qartë të forcës dhe parandalimit nga NATO.

Një reagim ndaj tërheqjes ruse të kërkesës së saj të furnizimit në portin spanjoll? A është ky një zhvillim pozitiv? Ju keni thënë vazhdimisht se NATO është një aleancë mbrojtëse, por a jeni të shqetësuar sikur jemi në situatë përshkallëzimi, ku NATO është duke dërguar tanke në krahun lindor dhe Rusia është duke dërguar anije në Detin Baltik, Rusia është e përforcuar në lindje mesdhetare, NATO është përforcuar në Detin e Zi. A është kjo një situatë e rrezikshme përshkallëzimi?

NATO nuk kërkon konfrontim me Rusinë. Ne nuk duam një luftë të re të ftohtë dhe ne nuk duam një garë të re armësh dhe për këtë arsye, ajo që NATO bën është mbrojtëse dhe është proporcionale. Në të njëjtën kohë, NATO duhet të reagojë kur ne, gjatë një periudhe të gjatë kohore, kemi parë ndërtime të konsiderueshme ushtarake nga Rusia, kemi parë ata të modernizojnë kapacitetet e tyre ushtarake dhe më e rëndësishmja, ne kemi parë ata të gatshëm të përdorin forcën ushtarake kundër fqinjëve: Krimesë, Ukrainës, kështu në këtë mënyrë Gjeorgjia ka parë

një retorikë kërcënuese nga Rusia. Pra, NATO duhet të përgjigjet, për të vazhduar për të ofruar sprapsje të besueshme në një mjedis të ri të sigurisë dhe ne duhet të kujtojmë se arsyeja pse ne kemi ofruar parandalimin, pse NATO është e fortë nuk është për shkak se ne duam që të provokojmë një konflikt, por kjo është për shkak se ne duam për të parandaluar një konflikt dhe mënyra më e mirë për të bërë këtë është për të qëndruar të fortë, të bashkuar dhe të jemi të vendosur në përgjigjen tonë.

Ne kombinojmë këtë mesazh me një mesazh shumë të qartë që ne kërkojmë dialog, ne kërkojmë një marrëdhënie më bashkëpunuese me Rusinë dhe ne duam transparencë. Prandaj, ne jemi transparentë në ushtrimet tona, ne jemi transparent në praninë tonë në rritje dhe në të vërtetë, në takimin e fundit të Këshillit NATO-Rusi, kemi shpenzuar shumë kohë të kalojë, për të shpjeguar atë që është duke bërë NATO, duke ilustruar pikërisht atë që ne jemi duke bërë, por edhe duke qenë transparent, duke kontribuar për tu përkujtur për të shmangur tensionet gjithashtu me të rritura. Dhe sidomos kur tensionet janë të larta, është e rëndësishme që ne të mbajmë kanale për dialog politik të hapura. Pastaj, ne kemi parë vendosjen e trupave të aseteve të ndryshme. Në të njëjtën kohë, unë mendoj se është e rëndësishme të theksohet se çdo popull ka të drejtë të ushtrojë trupat e tyre, forcat e saj dhe Rusia ka të drejtë për të vepruar në ujërat ndërkombëtare me asetet e saj detare. Pra, për mua, që nënvizon rëndësinë për të mos reaguar në çdo rast individual, por shikoni foton strategjike më gjerë, të ketë një qasje strategjike dhe ne kemi bërë pikërisht këtë në bazë të zhvillimit, kemi parë gjatë një periudhe të gjatë kohore.

Në vazhdim të pyetjes më sipër, jeni të kënaqur nga shpjegimi që bëri qeveria spanjolle, për të mos lënë luftanijet ruse të furnizohen në territorin spanjoll?

E thashë këtë mëngjes se është në dorën e çdo kombi për të vendosur nëse ata sigurojnë furnizimin dhe furnizojnë anije detare dhe ky është ende pozicioni im. Në të njëjtën kohë, kam deklaruar se ne jemi të shqetësuar në lidhje me përdorimin e mundshëm të këtij grupi transportues për të rritur sulmet ajrore në Aleppo, duke rënduar katastrofën humanitare ... katastrofën që ne tashmë e shohim në Aleppo.



“Operacionet dhe aktivitetet e Ushtrimit “Shqiponja 5” te cilat i përcollëm sot janë dëshmi që FSK ka kapacitete për kryerjen e detyrave që aktualisht i ka të përcaktuara me mision. Ushtrimi ka dëshmuar se jemi të aftë të ndërveprojmë me institucione vendore dhe ndërkombëtare. Testimi i suksesshëm i njësive dhe suksesi i arritur dëshmon që FSK është e gatshme për detyra dhe përgjegjësi të reja”.



FSK: 652 pjesëtarë, ushtrimi fushor “Shqiponja 5”

Ushtrimi fushor “Shqiponja 5” është realizuar në bazë të Planit vjetor të trajnimeve për vitin 2016, udhëzimeve të komandantit të FSK-së, për grupin punues dhe direktivave të NATO-s për ushtrime dhe trajnimeve kolektive dhe ka përfunduar më 27 tetor 2016. Skenari i ushtrimit fushor ka qenë kriza me refugjatë dhe është zhvilluar në territorin e komunës së Hanit të Elezit, Malishevë dhe Prizrenit, në të cilin ushtrim, kanë marrë pjesë gjithsej 652 pjesëtarë, me 111 automjete, ku kanë realizuar mbi 30 operacione humanitare të sigurisë.

Në Ditën e vizitorëve të Ushtrimit fushor të FSK-së „Shqiponja 5”, morën pjesë: ministri i FSK-së, Haki Demolli, komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Rrahman Rama, komandanti i KFOR-it, gjeneral major Giovanni Fungo, drejtori i NLAT-it, gjeneral brigade Dietmar Mosman, deputetët e Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, kryetarët e komunave, komandantët e kontingjenteve të KFOR-it, ambasadorë dhe atashë të akredituar në Kosovë si dhe mysafirë të tjerë të ftuar, të cilët nga afër përcollën operacionet e njësive të FSK-së, të Gardës Kombëtare të Ajovës, të Ushtrisë Amerikane për Evropë, të Policisë së Kosovës si dhe të organizatave emergjente të Kosovës.

Në qendrën operative të ushtrimit fushor në kampin fushor, shefi i Shtabit të Komandës së forcave Tokësore të FSK-së edhe drejtori i ushtrimit i njoftoi vizitorët e lartë dhe të pranishmit për procesin dhe fazat e planifikimit, organizimit dhe zhvillimit të ushtrimit fushor sipas skenarit të para caktuar.



Me këtë rast, udhëheqësit e FSK-së, Gardës Kombëtare të Ajovës, KFOR-it, etj, përcollën nga afër demonstrimet e njësive të specializuara të FSK-së, në vend incidentesh si intervenimin e njësive të kërkim-shpëtimit të refugjatëve në lumin Drini i Bardhë, menaxhimin e hyrjes së refugjatëve në pikën kufitare, intervenimin e njësive të Brigada e Reagimit të Shpejtë (BRSH), në zonën kufitare për të eliminuar elementet e grupit kriminal “Pandora” si dhe vizitën

në Kampin e refugjatëve.

Ministri i FSK-së, Haki Demolli, në fjalën e tij para mediave dhe pjesëmarrësve të ushtrimit ka përgëzuar FSK-së, si dhe oficerët e Gardës Kombëtare të Ajovës, Ushtrisë Amerikane për Evropë të KFOR-it, dhe Policisë së Kosovës dhe agjencitë tjera të Kosovës për zhvillimin me sukses të ushtrimit fushor Shqiponja 5.

Ministri Demolli u nda i kënaqur me profesionalizimin e treguar në

këtë ushtrim të FSK-së, ku me këtë rast përgëzoi komandantin e FSK-së, gjenerallejtnant Rrahman Ramën për suksesin e FSK-së, të treguar gjatë ushtrimit më të madh të FSK-së.

Ministri Haki Demolli para mediave tha se qëllimi i këtij ushtrimi fushor është që të testohen respektivisht të demonstrohen dhe dëshmojnë dhe verifikohen në radhë të parë kapacitetet njerëzore, ushtarake të FSK-së, dhe kapacitete teknike për sfidat e ndryshme qoftë ato të karakterit humanitar por edhe të karakterit të sigurisë. Ky demonstrim i kapaciteteve të FSK-së është zhvilluar në praninë dhe vëzhgimin e vëzhguesve ushtarak të vendeve mike që kanë qenë të pranishëm gjatë ushtrimit. Kemi pas vëzhgues ushtarak nga Shqipëria, Maqedonia, Kroacia si dhe nga Sllovenia, Nga ajo që pamë ne, mund të themi lirshet se FSK-ja është e gatshme për t'i kryer funksionet, aktivitetet dhe veprimtaritë e parapara sipas mandateve kushtetuese dhe ligjore të FSK-së. Që do të thotë ta ndërroj mandatin dhe misionin e vet dhe të transformohet në Forcë të Armatosur të Kosovës.

Në pyetjen e gazetarëve se kurë pritet të bëhet transformimi i FSK-së në ushtri? Ministri Haki Demolli u përgjigj se: “Se ne si ministri dhe FSK i kemi bërë të gjitha përgatitjet e duhura për

transformim të FSK-së në FA si janë, amandamentet kushtetuese dhe draft ligjin për transformimin e FSK-së në FA i kemi proceduar te organet kompetente përkatësisht te Qeveria e Kosovës dhe varet nga zhvillimet politike se kur kryesia e kuvendit do të vlerësojë kohën e duhur dhe sigurisht se do të procedojë më tutje. Por ajo çka dua të them është se ne si FSK dhe ministri e FSK-së jemi të gatshëm në çdo kohë të transformohemi në FA”.

Kurse komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Rrahman Rama u shpreh tejet i kënaqur me demonstrimet gjatë ushtrimit të sotëm. Ai pos tjerash tha se “Operacionet dhe aktivitetet e Ushtrimit “Shqiponja 5” te cilat i përcollëm sot janë dëshmi që FSK ka kapacitete për kryerjen e detyrave që aktualisht i ka të përcaktuara me mision. Ushtrimi ka dëshmuar se jemi të aftë të ndërveprojmë me institucione vendore dhe ndërkombëtare. Testimi i suksesshëm i njësive dhe suksesi i arritur dëshmon që FSK është e gatshme për detyra dhe përgjegjësi të reja”.

Objektivi i Ushtrimit fushor “Shqiponja 5” ishte trajnimi i liderëve dhe njësive për detyrat kolektive, me qëllim të realizimit të operacioneve komplekse në mbështetje të autoriteteve civile në fazën e planifikimit, ekzekutimit si dhe atë të analizimit. Mbajtja e nivelit të gatishmërisë operacionale dhe të zhvillohen aftësitë ekzistuese, përmirësimi i koordinimit me institucionet e tjera të sigurisë në operacion, dislokimi i forcave nga vend bazimi i përhershëm në zonën e operacionit dhe implementimi i sistemit të mësimave të mësuara.

“FSK dhe partnerët”

Në Ministrinë për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK), u mbajt konferenca e dytë vjetore „FSK dhe partnerët” nën organizimin e Departamentit për Bashkëpunim dhe Siguri të MFSK-së dhe me pjesëmarrjen e atashëve të Mbrojtjes të akredituar në vendin tonë, e ku ishin të pranishëm edhe ministri i FSK-së, zotëri Haki Demolli, komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Rrahman Rama, zëvendëskomandanti i KFOR-it, gjeneral brigade Christian Riener, gjeneral Steven Altman nga Garda Kombëtare e Ajovës, drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s, gjeneral Dietmar Mosman si dhe diplomatë dhe përfaqësues institucionale vendore dhe ndërkombëtare.

Në fjalën e hapjes, ministri i FSK-së Haki Demolli tha se Ministria e Forcës së Sigurisë, respektivisht FSK-ja, objektivi primar kanë intensifikimin e bashkëpunimit me partnerët, ku përmes të cilit shtetet mike të Republikës së Kosovës po ofrojnë mbështetje në forma të ndryshme në ngritjen e kapaciteteve tona. Gjithashtu, ministri Demolli tha se takimet e këtuja, si kjo konferencë apo ushtrimet e përbashkëta siç ishte ushtrimi i djeshëm fushor “Shqiponja V”, ku pjesëmarrës të planifikimit dhe realizimit të tij ishin edhe ushtarët dhe oficerët e Ushtrisë Amerikane dhe pjesëtarët e KFOR-it,

ndërsa shumë ushtarakë të shteteve mike ishin në cilësinë e vëzhguesve, po ndikojnë jo vetëm në rritjen e ndërveprimit ndërmjet nesh, por edhe në rritjen e mundësive për zhvillimin e trajnimeve të mirëfillta në përputhje me standardet veri-atlantike, e të cilat janë synim final i FSK-së dhe Republikës së Kosovës në tërësi. Nga ana e tij, komandanti i FSK-së, gjenerallejtnant Rrahman Rama tha se, FSK-ja që nga themelimi i saj është përkushtuar në ngritjen e kapaciteteve të veta, si në personelin ashtu edhe në infrastrukturë, në pajisje dhe në krijimin e kushteve sa më të mira për pjesëtarët tanë. Më tej, gjeneral Rama, duke i'u drejtuar mysafirëve, tha se: „Ju keni një rol kyç në këtë drejtim, sepse gjithçka që kemi bërë deri tani ishte në partneritet me ju dhe bazuar në standardet e NATO-s.” Prandaj, tha Komandanti i FSK-së „vazhdimi i këtij bashkëpunimi të shkëlqyeshëm është shumë i rëndësishëm për zhvillimin e mëtejshëm të FSK-së, si një institucion për të mirën e vendit dhe kontribuese e sigurisë”.

Nga një fjalë rasti në konferencë paraqitën edhe zëvendëskomandanti i KFOR-it, gjeneral brigade Christian Riener, gjenerali nga Garda Kombëtare e Ajovës, Steven Altman dhe gjeneral Mosman, drejtori i NLAT-it. Punimet e konferencës “FSK dhe

partnerët” i kryesoi, kolonel Ilir Qeriqi, ndërsa drejtorët, shefat dhe oficerët e departamenteve të Personalit, Financave, Operacioneve dhe Trajnimeve, Logjistikës, Mjekësisë, Planeve dhe Politikave, Sigurisë dhe Inteligjencës, Qendrës së Trajnimit të Kërkim-Shpëtimit, Komunikimit dhe Sistemeve të Informimit etj., prezantuan objektivat e zhvillimit si dhe paraqiten sfidat dhe nevojat për të ardhmen. Gjithashtu edhe atashetë e Mbrojtjes të vendeve partnere si ShBA, Mbretëria e Bashkuar, Turqia, Shqipëria, Kroacia, Hungaria, Italia, Gjermania, Holanda, Maqedonia dhe Japonia prezantuan kapacitetet dhe ofertat për mbështetje në fushat me interes për FSK-së për periudhën e ardhshme, si dhe diskutuan për aktivitetet në kuadër të planeve të bashkëpunimit dypalësh në të ardhmen.

Qëllimi i konferencës ishte rritja e ndërsjellë e bashkëpunimit dhe ndërveprimit në mes FSK-së dhe vendeve partnere, e po ashtu edhe Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATOS për MFSK-në dhe FSK-në (NALT) si organizëm mbështetës i FSK-së, e në të njëjtën kohë edhe përfaqësues të institucioneve të tjera të Republikës së Kosovës nga fusha e sigurisë dhe diplomacisë, më qëllim të qasjes



gjithëpërfshirëse të institucioneve relevante për sinkronizimin dhe ndërveprimin në mes institucioneve tona në të mirë të zhvillimit të kapaciteteve të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Duhet cekur se në konferencë ishin të pranishëm edhe zëvendësmministri i FSK-së, Muhamet Latifi, gjeneral brigade Zymer Halimi, drejtori i Drejtorisë për Operacione, zëvendëskomandanti i Forcave Tokësore, gjeneral Gëzim Hazrolli, shefi i Departamentit për Operacione dhe Trajnime, gjeneral brigade Nazmi Brahimaj, drejtori i Inspektoratit, gjeneral brigade Bashkim Jashari, komandanti i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes, gjeneral brigade

Enver Cikaqi, shefi i shtabit të Komandës së Forcave Tokësore, kolonel Naim Haziri, këshilltari ushtarak i ministrit, kolonel Fadil Hadergjonaj, atashetë e FSK-së të akredituar në Gjermani, Shqipëri, vendet e Beneluksit dhe Turqi, sikurse janë kolonel Xhavit Sadriaj, nënkolonel Enver Dugolli, nënkolonel Ahmet Ajeti dhe nënkolonel Bekim Osmani, si dhe përfaqësues nga Policia e Kosovës, përfaqësues nga Ministria e Punëve të Jashtme e Republikës së Kosovës, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave të Kosovës, si dhe organizata joqeveritare si Këshilli Euro-Atlantik i Kosovës dhe Asociacioni i Paktit Atlantik të Rinisë së Kosovës.



“Pjesëmarrja e rreth 150 pjesëtarëve të Armatës së Republikës së Maqedonisë në një nga trajnimet më të mëdha këtë vit “Anakonda 160 është dëshmi se bashkëpunimi rrjedh pa ndërprerë dhe se edhe Forcat Tokësore të SHBA-së, por edhe NATO-ja fuqishëm besojnë në kapacitetet e ARM-së”



Maqedoni-SHBA, partneritet strategjik në mbrojtje

Ben Hodges-komandanti i forcave tokësore të SHBA-ve për Evropën, gjeneral-nënkolonel Frederick, në Maqedoni

Republika e Maqedonisë dhe SHBA-ja vazhdojnë ta zhvillojnë partneritetin strategjik, e cila veçanërisht është e shprehur në fushën e mbrojtjes”, deklaroi ministri i Mbrojtjes Zoran Jolevski dhe komandanti i Komandës së forcave tokësore të SHBA-së për Evropë, gjeneralnënkoloneli Ben Hodges në takim të zhvilluar në Shkup, datë 1 nëntor në Ministrinë e Mbrojtjes. Në takim ministri Jolevski potencoi se Ministria e Mbrojtjes dhe Armata e Republikës së Maqedonisë kanë marrëdhënie të shkëlqyera me forcat e armatosura të SHBA-së, veçanërisht me Komandën e Forcave Tokësore të SHBA-së për Evropë, e cila manifestohet përmes aktiviteteve dhe trajnimeve të përbashkëta.



“Pjesëmarrja e rreth 150 pjesëtarëve të Armatës së Republikës së Maqedonisë në një nga trajnimet më të mëdha këtë vit “Anakonda 160 është dëshmi se bashkëpunimi rrjedh pa ndërprerë dhe se edhe Forcat Tokësore të SHBA-së, por edhe NATO-ja fuqishëm besojnë në kapacitetet e ARM-së”, tha ministri në takim. Jolevski shtoi se përmes trajnimeve të cilat planifikohen për vitin e ardhshëm do të vazhdojë trendi i përparimit të interoperabilitetit të ARM-së me armatat e vendeve-anëtare të NATO-s, që, ashtu siç tha, është nga vlera e veçantë për Maqedoninë, duke e pasur parasysh se anëtarësimi në Aleancë mbetet përcaktim strategjik i vendit.

mbetet e përkushtuar për të ndihmuar Maqedoninë në integrimin e saj të plotë në NATO. Ndërsa në takimin e zhvilluar, Shefi i Shtabit të ARM-së, Metodija Veliçkovski, tha se pjesëmarrja e forcave të ARM-së në misionin e fundit ndërkombëtar “ANAKONDA”, si dhe kapacitetet dhe arritjet e tyre u vlerësuan së tepërmi nga komandanti Hodges. Kjo sipas tij, dëshmon se Maqedonia është duke ecur në rrugën e duhur dhe një ditë do të marrë vendin që e meriton, partner i barabartë në NATO. “Ne bashkarisht shprehëm kënaqësi për bashkëpunimin e ushtrive tona dhe e vlerësuam të shkëlqyer. Megjithatë,

shpalosëm hapësirë dhe mundësi për bashkëpunimin e mëtejshëm, kryesisht në fushën e edukimit dhe trajnimeve ushtarake, për të cilën presim që mbështetja të vazhdojë edhe në të ardhmen”, deklaroi Veliçkovski. Gjenerali Ben Hodges, i cili qëndron për vizitë dyditëshe në Armatën e Republikës së Maqedonisë, ka vizituar edhe Batalionin e Policisë Ushtarake. Gjatë ditës gjenerali e vizitoi edhe Akademinë Ushtarake, ku realizoi takim edhe me një pjesë të kadetëve me të cilët ka biseduar për lidhshirësinë në ushtri dhe vlerën e profesionit ushtarak, ndërsa tre kadetëve më të mirë u dha mirënjohje.

NATO & BE: Anëtarësimi ynë prioritet strategjik

Anëtarësimi në Aleancë dhe në Bashkimin Evropian mbetet prioritet i nyi strategjik. Marrë parasysh ndryshimet gjeopolitike në suaza globale, proceset integruuese në strukturat euroatlantike ndikojnë pozitivisht në zhvillimin e paqes, bashkëpunimit, si dhe zhvillimin ekonomik dhe demokratik të shteteve. Këtë e theksoi ministri i mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë, Zoran Jolevski në fjalën e tij në „Future Forces Forum 2016” që u mbajt në Pragë. Çeki. Ministri Jolevski në këtë forum ishte i shoqëruar nga gjenerali Vasko Gjurginovski, komandant i Komandës së Bashkuar Operative të ARM-së.

Ministri Jolevski theksoi se proceset reformuese në mbrojtje dhe në fushat tjera vazhdojnë, sepse ato janë parësish të mira për ne, qytetarët tanë, dhe më pas edhe për procesin e integritetit euroatlantik. Në këtë kontekst, ministri u falënderua për mbështetjen e hapur dhe parimore për anëtarësim në NATO nga ana e nikoqirit, Republikës së Çekisë.

„Zhvillimi dinamik në skenën ndërkombëtare të sigurisë kërkon ndjekje të vazhdueshme dhe përshtatje ndaj kërcënimeve dhe rreziqeve të sigurisë. Republika e Maqedonisë i takon rajonit Euroatlantik dhe siguria e saj është e pandashme nga siguria e rajonit dhe më gjerë,” tha ministri. Ai shtoi se bota përballet me më shumë sfida, rreziqe dhe kërcënime, midis të cilave përmendi terrorizmin, krimin e organizuar transnacional, luftën hibride, migrimin ilegal etj. Në kontekst të migrimit, ministri tha se për shkak të pozitës së saj gjeografike, Maqedonia u gjet në një situatë të komplikuar vitin e kaluar nga fluksi i emigrantëve. „Krizat aktuale e emigrantëve paraqet një dukuri të pavërejtur në historinë e re, dukuri e cila kapërcen kufijtë kombëtar dhe kërkon angazhim të koordinuar global dhe rajonal,” tha ministri në Forum.

Poashtu, në margjinat e forumit, ministri realizoi edhe disa takime bilaterale midis të cilave edhe me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura çeke, gjeneralin Josef Bečvar, si dhe me gjeneralin Petër Pavel, kryesues i Komitetit Ushtarak të NATO-s.

Në takimin me gjeneralin Bečvar, ministri Jolevski shprehu falënderim nga niveli i bashkëpunimit midis dy armatave. „Në bashkëpunime më në shumë çështje nga fusha e mbrojtjes, ne veçanti në përbashkëpunimin me krizën e emigrantëve, shkëmbimin e informacioneve për gjendjen aktuale të sigurisë, si dhe në fushën e arsimimit ushtarak,” tha ministri dhe shtoi se ky bashkëpunim do të vazhdojë dhe do të intensifikohet në të ardhmen.

VIZITA



ARM stërvitje të përbashkëta me NATO-n

Zoran Jolevski takon në SHBA zëvendës ndihmës sekretarin për mbrojtje, Majkel Karpenter


Gjatë vizitës së punës në SHBA më 25.10.2016 ministri Zoran Jolevski në Pentagon zhvilloi takim pune me zëvendës ndihmës sekretarin për mbrojtje, Majkel Karpenter. Në takim Karpenter fillimisht uroi ministrin Jolevski për vendimin e ministrave të mbrojtjes të vendeve-anëtare për iniciativën për bashkëpunim në Evropën Juglindore (SEDM) që Republika e Maqedonisë të jetë nikoqire e Shtabit Qendror të Brigadës së Evropës Juglindore (SEEBRIG) në periudhën nga 2020 – 2026, si dhe për fillimin me punë të Komandës së Forcave Ushtarake Mjekësore në Shkup. Në takim ministri Jolevski njoftoi Karpenter-in me reformat të cilat zbatohen në fushën e mbrojtjes. Në veçanti, ai u ndal në modernizimin e ARM-së dhe pjesëmarrjen në operacionet paqeruajtëse. Karpenter shprehu kënaqësi nga progresi që Ministria e Mbrojtjes ariti në periudhën e kaluar dhe njëkohësisht u falënderua për mbështetjen e deritanishme që Republika e Maqedonisë e jep në misionet e NATO-s. Dy bashkëbiseduesit u pajtuan se vitin e ardhshëm duhet të shtohet intensiteti i bashkëpunimit në fushën e stërvitjeve të përbashkëta.

Po ashtu, në këtë takim u shkëmbyen informacione lidhur me gjendjen aktuale të sigurisë në Irak dhe Siri, ndërsa bashkëbiseduesit shkëmbyen edhe vështrimet mbi implikimet nga ndodhitë në Irak dhe Siri ndaj gjendjes së sigurisë në Evropë, përfshirë këtu edhe Evropën Juglindore.

Gjatë ditës ministri Jolevski realizoi takim pune me gjeneralin amerikan Xhejms Xhons, ish këshilltar për siguri kombëtare dhe komandant i NATO-s. Në takim u shqyrtuan mundësitë rreth avancimit të bashkëpunimit dhe investimet e menjëhershme të drejtpërdrejta në Poligonin Ushtarak „Krivollak” me qëllim të forcimit të kapaciteteve dhe të transformimit të PU „Krivollak” në një qendër trajnuese elitare në rajonin e Evropës Juglindore. Me këtë do të ngritej në mënyrë të konsiderueshme cilësia e trajnimeve dhe gatishmëria luftarake e ARM-së.



Në këtë takim u shkëmbyen informacione lidhur me gjendjen aktuale të sigurisë në Irak dhe Siri, ndërsa bashkëbiseduesit shkëmbyen edhe vështrimet mbi implikimet nga ndodhitë në Irak dhe Siri ndaj gjendjes së sigurisë në Evropë, përfshirë këtu edhe Evropën Juglindore.



Sekretari i përgjithshëm i NATO-së Jens Stoltenberg tha se pritet se gjatë shkurtit të vitit 2017 do të merret vendim për rritjen e pranimit të Aleancës në rajonin e Detit të Zi. Çështja diskutohet prej shumë kohësh dhe tani për tani s'ka vendim përfundimtar, sepse në kontekstin e situatës rreth Ukrainës ajo është tepër delikate.



Një frigate në operacionin e NATO-së në Mesdhe

Bullgaria do të marrë pjesë në operacionin e NATO-së në Mesdhe "Rojtari detar", informoi në Bruksel ministri i mbrojtjes Nikollaj Nençev. Anijet luftarake të NATO-së do të bashkëpunojnë me misionin evropian "Sofje" në Mesdheun Qendror. Ato do t'u kundërvënë trafikantëve të njerëzve që vijnë nga brigjet e Libisë. Në pjesëmarrjen e tij në mbledhjen e parë të ministrave të Aleancës ministri Nençev saktësoi: "Ky vendim akoma nuk është marrë. Do të marrim pjesë me një fregatë, siç kemi bërë deri tani. Ushtarakët bullgarë nuk do të përfshihen në rotacionin e katër batalioneve të NATO-së, të cilat do të dërgohen në kufirin lindor të Aleancës me Rusinë, shpalli ministri i mbrojtjes.



Nuk do të shtohen forcat në kufirin me Rusinë

Në përgjigje të vendimit të Rusisë të vendosë 330 mijë ushtarë në kufirin e vet perëndimor, ministri i mbrojtjes të NATO-së morën vendim për krijim të katër grupeve ushtarake me pothuaj 4000 veta në shtetet baltike dhe në Evropën Lindore. SHBA-ja do të dërgojë një batalion me 900 ushtarë në Poloninë Lindore. Që nga maji i vitit të ardhshëm në Estoni do të dislokohet një batalion me 800 ushtarë nga Briatnia e Madhe, Danimarka dhe Franca. Kanadaja dhe Italia do të dërgojnë trupa në Letoni, kurse Gjermania, Holanda dhe Norvegjia, Belgjika, Luksemburg dhe Kroacia-në Lituanë. Briatnia e Madhe do të dislokojë në Rumani avionë gjuajtës "Tajfun" për patrullim rreth Detit të Zi. Këtë dislokim të forcave ushtarake "Reuters"-i e cilësoi si "mbledhja më e madhe ushtarake rreth Rusisë pas Luftës së Ftohtë". Bullgaria nuk është përmendur në këtë situatë dhe kjo tregon se Sofja ka një pozitë të përmbajtur. Dhe në të vërtetë ministri i mbrojtjes Nikollaj Nençev tha se ushtarët bullgarë nuk do të marrin pjesë në batalionet e reja në kufirin lindor të NATO-së me Rusinë.

Në këtë etapë ndaj palës bullgare nuk është bërë një kërkesë e tillë dhe ajo s'ka ndër mend të marrë pjesë në formacionet e ardhshme, sepse mendon se angazhimi i saj i deritanishëm me 400 ushtarë në brigadën shumëkombëshe të NATO-së në Rumani është i mjaftueshëm. Ky angazhim nuk është i përhershëm, por në rast të nevojës zhvillohet në parim rotacioni.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-së Jens Stoltenberg tha se pritet se gjatë shkurtit të vitit 2017 do të merret vendim për rritjen e pranimit të Aleancës në



rajonin e Detit të Zi. Çështja diskutohet prej shumë kohësh dhe tani për tani s'ka vendim përfundimtar, sepse në kontekstin e situatës rreth Ukrainës ajo është tepër delikate. Në mbledhjen e fundit të

NATO-së në Bruksel shumë ministra shprehën shqetësime në lidhje me situatën rreth Detit të Zi dhe nënvizuan domosdoshmërinë për prani të përfurcuar nën formën e stërvitjeve. Pozita e Sofjes është përmbajtur edhe për këtë çështje dhe përjashton angazhime të dakorduara mes shteteve të ndryshme të NATO-së. Ministri i mbrojtjes Nençev vazhdon të jetë kundër marrëveshjeve të tilla me Rumaninë dhe Turqinë, mirëpo nuk përjashton mundësinë për arrijen e një pozite të përbashkët me Rumaninë gjatë dhjetorit, para diskutimit të çështjes në NATO. Në fakt Bullgaria mori angazhim për pjesëmarrje me një fregatë vetëm në operacionin e ri të Aleancës në Mesdhe në parim rotacioni në kuadrin e një muaji disa herë në vit. Mirëpo ky operacion nuk është pjesë e grumbullimit të madh të forcave në kufirin me Rusi, është pjesë e përpjekjeve ndërkombëtare për ndalimin e presionit të migrantëve ndaj Evropës. Në mënyrë modeste Bullgaria merrte pjesë në këto përpjekje edhe deri tani si një shtet i prekur drejtpërsëdrejti nga migracioni.

Helikopterë "Cougar" në kërkim të zhdukurit 34-vjeçar

Nga baza ajrore Krumovo është nisur me 1 nëntor helikopteri "Cougar" bashkë strukturta të Forcave Tokësore Ajrore Ushtarë nga Forcat Tokësore dhe helikopteri "Cougar" në kërkim të 34-vjeçarit Miroslav Kasovski në

Kalofer Ballkan. Veprimet e Shtabit të Krizës u koordinuan personalisht nga Shefi i Përgjithshëm i Mbrojtjes Konstantin Popov. "Ushtarakët të veprojnë së bashku me zyrtarët e Ministrisë së Brendshme Shpëtim Mountain, park "Central Balkan" dhe vullnetarë. Në total, më shumë se 400 njerëz janë të përfshirë në kërkim", tha shefi i Përgjithshëm i Mbrojtjes Konstantin Popov. Rreth 300



ushtarë nga Brigada 61 e mekanizuar me pajisje dhe avionë pa u angazhuan marrë në kërkim të 34-vjeçarit Miroslav Kasovski. Ata po veprojnë në dy drejtime. Kërkimi vazhdon në drejtim të Botev Peak, ku gjoja u zhduk Miroslav Kasovski i cili ka humbur që nga 26 tetor 2016.

Ushtria e gatshme për të ndihmuar popullatën

"Në prag të Ditës së Liderëve Kombëtare ne kemi nevojë për të kujtuar shembullin dhe sakrificën e ushtarëve bullgarë," tha Ministri i Mbrojtjes Nikolai Nençev, më 31 tetor, në ceremoninë e Memorialit Zetyovo, komuna Chirpan. Nençev Ministri vlerësoi ushtarët bullgarë të cilët kryejnë detyra në kufi dhe që marrin pjesë në misionet jashtë vendit. "Sot ushtarë nga ushtria bullgare u bashkua me operacionet e shpëtimimit për të kërkuar të riun e zhdukur në Stara Planina", tha ministri i mbrojtjes dhe tha se "ushtria është gjithmonë i gatshëm për të ndihmuar popullatën". Ai shprehu mirënjohjen e tij për punën vetëmohues dhe profesionale të burrave dhe grave në uniformë. Veprimtaria u ndoq George Ranov, Guvernatori Qarkut të Stara Zagora, Kostadin Kuzmov, komandant i Brigadës së Dytë Tundzha, përfaqësues të autoriteteve lokale nga komuna e Chirpan. Po kështu Ministri Nençev mori pjesë në ceremoninë "Buditel i Vitit" në fshatin Zetyovo organizuar me rastin e Ditës së Liderëve Kombëtare.



Kina prezanton avionin luftarak J-20

Kina është ende larg forcës ajrore të Shteteve të Bashkuara dhe të Rusisë, por vendi i madh aziatik është duke e ngushtuar me hapa të shpejtë hendekun me dy superfuqitë e tjera ushtarake botërore. E pikërisht këtij objektivit i shërben edhe prezantimi i avionit bombardues J-20, i shfaqur për herë të parë në publik në provincën Guangdong. Avionët janë të pajisur me teknologjinë e fjalës së fundit dhe të pakapshëm nga radarët, çka ka bërë që shumë ekspertë të aviacionit

ushtarak ta cilësojnë atë një kopje të modelit amerikan F-22 Raptor, prodhuar nga Lockheed Martin. Brenda një dekade Kina pritet të shndërrohet në vendin me tërheqës për industrinë e aviacionit, si civil ashtu edhe ushtarak. Sa i përket këtij të fundit, Presidenti Xi Jinping është angazhuar të forcojë dhe modernizojë ushtrinë, sidomos në jug-lindje të vendit, aty ku ka konteste me pjesën më të madhe të vendeve fqinjë për ujërat në Detin e Kinës.



Ekspozita ndërkombëtare e aviacionit

Ekspozita e 11-të ndërkombëtare e aviacionit e Kinës u hap të martën në Zhuhai të Kinës Jugore. Në këtë ekspozitë prezantohet për herë të parë avioni i fundit luftarak i pagjurmshëm i Kinës J-20. Krahas kësaj edhe aeroplanmbajtësja Y-20 në muajin korrik do të prezantohet për herë të parë në publik. Këto pajisje me teknologji moderne tregojnë zhvillimin e 20 viteve të fundit të sektorit të pajisjeve të aviacionit.

Sivjet është viti i 20-të i ekspozitës së aviacionit. Në këtë ekspozitë janë prezantuar pajisje të fundit të aviacionit të Kinës. Grupi i Industrisë së Aviacionit të Kinës AVIC bëri të ditur se këtë herë, do të shfaqen mbi 160 prodhime dhe sisteme të fundit, si avioni luftarak J-10B, helikopteri ZH-10K, bombarduesi H-6K dhe avioni paralajmërues KJ-500. Ndër të gjitha këto, avioni luftarak J-20 do të shfaqet në ajër për një njohje reale me publikun.

J-20 është avioni i fundit luftarak i pagjurmshëm i prodhuar nga Kina. Forcat ajrore kineze konfirmuan që pilotët e forcave ajrore do të drejtojnë J-20 për demonstrim ajror në Ekspozitën e 11-të Ndërkombëtare të Zhuhai-t, që do të jetë hera e parë që tipi i ri i avionit të pagjurmshëm të Kinës i shfaqet publikut. Lidhur me këtë, zv/kryemenaxheri i grupit AVIC Zhang Xinguo është i mendimit se shfaqja e parë e avionit J-20 tregon që ai është në fazën e kërkimit dhe programimit dhe do të futet në fazën eksperimentale.

Zhang Xinguo mendon që ekspozita ndërkombëtare e Zhuhai-t është një dritare që shfaq aftësinë e Kinës në industrinë e aviacionit. Pas kësaj dritareje qëndron kërkimi prej dhjetra vjetësh.

“Produktet që shohim tani nuk mund të tregojnë të gjithë procesin e kërkimit dhe prodhimit. Nëpërmjet ekspozimit të avioneve mund të imagjinojmë që në dekadat e fundit, kemi patur përparim të madh industrial dhe teknologjik. Përparimi më i dukshëm është që nga avioni i brezit të 2-të deri në atë të brezit të 3-të, kanë kaluar afro 18 vjet, ndërsa për në brezin e fundit 20, kemi harxhuar vetëm 8-9 vjetë, sa gjysma e kohës së mëparshme. Nga njëra anë, kjo është për arsye të përmbledhjes së eksperiencave dhe teknikave të mëparshme dhe nga ana tjetër rinovimi industrial ka ndryshuar teknikën e vjetër dhe mënyrat e prodhimit, duke shtuar efikasitetin,” thotë Zhang Xinguo.



Raketa mbartëse “Marshimi i Madh-5”

Gao Xu i Qendrës së Lëshimit Wenchang në Hainan, thotë se provat po zhvillohen, teksa “Marshimi i Madh-5” është mbushur me karburantin e vet kryesor, hidrogjenin e lëngshëm. “Ne kemi bërë shumë lidhur me ruajtjen, transportimin, mbushjen dhe sigurimin e hidrogjenit të lëngshëm. Ne duhet ta bëjmë këtë për të garantuar sigurinë e të gjithë objektit, si dhe të njerëzve në kullën e lëshimit dhe përreth saj,” u shpreh Gao Xu. Tang Jianguo, kreu i Qendrës së Lëshimit Wenchang, thotë se lëshimi i “Marshimi i Madh-5” do të jetë prova e parë e dizajnit të ri të raketës mbartëse: Misioni i planifikuar i lëshimit do të testojë saktësinë dhe besueshmërinë e dizajnit, si të raketës “Marshimi i Madh-5”, ashtu edhe të kullës së lëshimit. Pas lëshimit të parë, të tjera raketa “Marshimi i Madh-5” do të përdoren për të nisur satelitë orbitalë komunikimi, si dhe sonda në Hënë dhe Mars.” “Marshimi i Madh-5” ka kapacitetin më të madh ndër raketat mbartëse të Kinës. Raketa “Marshimi i Madh-5” ka një diametër prej 5 metrash dhe përmban katër raketa shtytëse me diametër prej 3.35 metrash. “Marshimi i Madh-5” do të forcojë shumë aftësinë e fluturimeve kozmike të Kinës.



Stërvitje me municion luftarak

Garnizoni i Hong-Kongut i Ushtrisë Çlirimtare Popullore (UÇP) zhvilloi të hënë një stërvitje me municion luftarak, me pjesëmarrjen e forcave ajrore, detare dhe tokësore. Gjatë stërvitjes u simulua një sulm kundër një grupi militantësh të armatosur në një zonë malore.

Stërvitja filloi me vrojtimin e pozicioneve të militantëve, i pasuar nga përdorimi i avionëve gjuajtës dhe i armëve të rënda të zjarrit për të mbështetur përparimin e ekepeve luftarake. Stërvitja përfshiu edhe sulme me precizion me raketa kundër një njësie të blinduar të armikut nga 1 600 metra lartësi.

Komisionari i Shërbimeve Riedukuese të Hong-Kongut Yau Chi-chiu tha se stërvitja ishte e suksesshme: “Jam i impresionuar nga stërvitja dhe besoj se Garnizoni i Hong-Kongut i Ushtrisë Çlirimtare Popullore do të zbatojë përgjegjësitë e tij për mbrojtjen e Hong-Kongut dhe të vendit në një mënyrë shumë profesionale.” Garnizoni i Hong-Kongut i Ushtrisë Çlirimtare Popullore është përgjegjës për detyrat e mbrojtjes në Rajonin e Posaçëm Administrativ të Hong-Kongut, që kur sovraniteti i rajonit i kaloi Kinës në vitin 1997.



Stërvitja "JCET-16"

Forcat speciale të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, bashkë me forcat speciale të komisariatit special "RENEA" dhe efektivë nga Grupi i 19 i Forcave Speciale amerikane, morën pjesë në stërvitjen Joint Combined Exchange Training, JCET, e cila u zhvillua në vendin tonë në periudhën 1-31 tetor 2016. Stërvitja JCET u zhvillua kryesisht në mjediset stërvitore të batalionit të Forcave Speciale në Garnizonin Zall-Herr, por ajo është shtrirë edhe në disa pjesë të caktuara të qytetit të Tiranës. Pjesë e stërvitjes ishte improvizimi i një skenari në Universitetin e Arteve në Tiranë, ku ishte marre "peng" personeli dhe ku trupat pjesëmarrëse demonstuan veprime që synonin të ishin sa më afër realitetit duke demonstruar kapacitetet dhe aftësitë operationale, në një operacion të përbashkët të trupave speciale ushtarake dhe atyre policore të përfaqësuara nga komisariati "RENEA". Ky demonstrim u ndoq nga afër dhe me mjaft interes nga zëvendësministri i Mbrojtjes z. Petro Koçi, komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Nazmi Cahani, atasheu ushtarak i SHBASë në vendin tonë, shefi i zyrës së ODC, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit drejtësi i Parë Haki Çako, drejtori i Forcave Operacionale të Lëvizshme drejtuesi parë Niko Brahimi, komandanti i Komisarariatit "RENEA" drejtues Sokol Poçari, komandanti i batalionit të Forcave Speciale kolonel Ekland Dauti, drejtorë drejtorish në SHPFA etj.

Në fjalën e tij zëvendësministri i Mbrojtjes z. Ptero Koçi tha se: "Kjo është një stërvitje e përvitëshme dhe më vjen mirë që ne çdo vit e më tepër kualifikohemi më tej për të garantuar sigurinë për të qenë më operabel në veprimatrinë tonë".

Më tej ai i falenderoi për suksesin e kësaj stërvitjeje dhe tha se dhe mirëpresim bashkëpunime të tjera në mënyrë që efikasiteti i këtij bashkëpunimi të jetë maksimal sepse sfidat që kemi përpara janë vërtetë të rëndësishme. Në këtë stërvitje morën pjesë edhe 3 vetë, personel i Forcës Sigurisë Kosovës me statusin "vëzhgues". Stërvitja JCET është stërvitje e cila zhvillohet 2 herë në vit në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me SHBA.

